



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## AVOKATI I POPULLIT

### RAPORT

Ex officio nr. 468/2022

#### Detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna

Për: Z. Jetish Maloku, kryesues  
Këshilli Prokurorial i Kosovës

Z. Gazmend Hoxha, drejtor i përgjithshëm  
Policia e Kosovës

Z. Xhelal Sveçla, ministër  
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Hekuran Murati, ministër  
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Z. Blerim Olluri, kryeshef ekzekutiv  
Agjencia e Kosovës për Forenzikë

Z. Ditor Haliti, zëvendësdrejtor i përgjithshëm  
Instituti i Mjekësisë Ligjore

Z. Përparim Rama, kryetar  
Komuna e Prishtinës

Z. Vebi Mujku, drejtor  
Qendra për Punë Sociale në Prishtinë

Kopje:

Z. Habit Hajredini, drejtor  
Zyra e Kryeministrit, Zyra për Qeverisje të Mirë

Prishtinë, 3 prill 2023

## Qëllimi i raportit

Korniza ligjore në Kosovë garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut përfshirë edhe të drejtat e fëmijës. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e respektimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut, ndërsa në rastet që kanë të bëjnë me fëmijët, të gjitha veprimet të ndërmarra, qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve. Sipas përcaktimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shtetet kanë për detyrë të ndërmarrin masa të parashikuara për të siguruar që individët, brenda juridiksionit të tyre, nuk i nënshtrohen keqtrajtimit, përfshirë keqtrajtimin e ushtruar nga individë privatë. Në rastet e abuzimit seksual, fëmijët janë veçanërisht të cenueshëm dhe e drejta për dinjitetin njerëzor, për integritetin fizik dhe psikologjik kërkon vëmendje të veçantë kur një fëmijë është viktimë e dhunës.

Qëllimi i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen e institucioneve publike lidhur me detyrimet pozitive të shtetit përkitazi me mbrojtjen e fëmijës nga dhuna.<sup>1</sup> Raporti vlerëson se sa kanë qenë efektive, të arsyeshme dhe të shpejta veprimet e ndërmarra nga institucionet kompetente shtetërore, me qëllim të mbrojtjes së fëmijës nga dhuna, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet si dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare.

## Kompetencat e Avokatit të Popullit

1. Në përputhje me nenin 132 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.”* Kushtetuta më tutje në nenin 135, paragrafi 3, parasheh: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
  - *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit (neni 16, paragrafi 1);*
  - *të bëjë hetime qoftë për t’iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (neni 16, paragrafi 4);*
  - *Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura*

<sup>1</sup> Lidhur me rastin e publikuar nga mediat për dhunimin e një vajze të mitur në Prishtinë, në tërë tekstin e këtij raporti, i referohemi fëmijë. Në rastet e tjera ku do që vëreni termin: dëshmitar, i mitur, viktimë etj. i referohemi emërtimit të cilin e kanë përdorur institucionet në dokumentacionin e çështjes.



*tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave (neni 16, paragrafi 8);*

- *të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla (neni 18, par. 1, nënpar. 1.2);*
- *t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.”* (neni 18, par. 1, nënpar. 6).

### **Veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit**

3. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4<sup>2</sup>, të Ligjit për Avokatin e Popullit, më 31 gusht 2022 ka hapur rast ex-officio, bazuar në informatat nga portali<sup>3</sup> “Sinjal”, në shkrimin me titull: “*Këta janë dy nga pesë të dyshuarit për dhunimin e 11-vjeçares në Prishtinë*”, i datës 28 gusht 2022. Ndërsa sipas portalit<sup>4</sup> “Telegrafi”, në shkrimin me titull: “*Rasti i dhunimit të 11 vjeçare në Prishtinë, Prokuroria thotë se e njëjta në qershor të këtij viti ishte raportuar si e zhdukur*”, i datës 1 shtator 2022.
4. Më 12 dhe më 26 shtator 2022, lidhur me çështjen, prindi i fëmijës ishte në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm: IAP).<sup>5</sup> Ai ishte njoftuar se për këtë çështje ishte hapur rast ex-officio dhe ishte duke u trajtuar nga IAP-ja.
5. Më 7, 8, 9 dhe 12 shtator 2022, përfaqësuesi i IAP-së kishte biseduar me përfaqësuesin/en e Qendrës për Punë Sociale (në tekstin e mëtejshëm: QPS) në Prishtinë, për t'i marrë informatat e nevojshme lidhur me çështjen.
6. Më 13 shtator 2022, përfaqësuesi i IAP-së kishte kërkuar nga QPS-ja sigurimin e një kopjeje të dosjes së rastit me të gjitha veprimet e ndërmarra nga QPS-ja.
7. Më 19 shtator 2022, përmes shkresës, Avokati i Popullit kishte kërkuar nga Policia e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Policia) t'ia siguronte një kopje të dosjes së rastit me të gjitha veprimet e ndërmarra nga Policia.
8. Më 20 shtator 2022, përmes shkresës, Avokati i Popullit kishte kërkuar nga Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (në tekstin e mëtejshëm: ZMNV) t'ia siguronte një kopje të dosjes së rastit me të gjitha veprimet e ndërmarra nga ZMNV-ja.
9. Më 27 tetor 2022, përmes shkresës, Avokati i Popullit kishte kërkuar nga Prokuroria Themelore e Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm: Prokuroria) informata për veprimet që ishin ndërmarrë në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësive ligjore, lidhur me rastin, për periudhën kohore 21 qershor 2022 deri më 27 gusht 2022.

---

<sup>2</sup>Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime qoftë për t'iu përgjigjur ankesës së parashtruar apo me iniciativën e vet (ex-officio), nëse nga konstatimet, nga dëshmitë dhe nga faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut, të përcaktuara me Kushtetutë, me ligje dhe me akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

<sup>3</sup><https://sinjali.com/keta-jane-dy-nga-pese-te-dyshuarit-per-dhunimin-e-11-vjecares-ne-prishtine/>

<sup>4</sup><https://telegrafi.com/rasti-dhunimit-te-11-vjecares-ne-prishtine-prokuroria-thote-se-e-njejta-ne-qershor-te-ketij-viti-ishte-raportuar-si-e-zhdukur/>

<sup>5</sup> A.483/2022



10. Më 27 tetor 2022, përmes shkresës, Avokati i Popullit kishte kërkuar nga Agjencia e Kosovës për Forenzikë (në tekstin e mëtejme: AKF) informatat: “[...] *se si i keni të rregulluara afatet procedurale prej momentit të pranimit të dëshmimeve për ekspertime deri tek përfundimi dhe dorëzimi tek institucioni kërkuar. Nëse i keni të përcaktuar afatet lidhur me çështjen, na dërgoni aktin juridik përkatës.*”
11. Po ashtu, përmes shkresës (më 27 tetor 2022), Avokati i Popullit kishte kërkuar përgjigje nga Prokuroria në disa pyetje, në mënyrë që t’i kishte informatat e duhura dhe pasqyrën e qartë lidhur me rastin e paraqitur në Polici, më 21 qershor 2022: “*A keni pranuar përgjigje nga Instituti i Mjekësisë Ligjore për zbatimin e Vendimit (PN. NR.20/22, dt.22.06.2022) që të bëjë ekzaminimin fiziko-gjinekologjik të të dëmtuarës, nëse po kur e keni pranuar? A keni pranuar përgjigje nga Agjencia Kosovare për Forenzikë për zbatimin e Urdhëresës (PN.20/2022, dt. 23.06.2022) për ekzaminimin e ADN, nëse po kur e keni pranuar? A keni pranuar përgjigje nga Agjencia Kosovare për Forenzikë për zbatimin e Vendimit (RNM.nr.20/2022, dt.24.06.2022) që të bëjë ekzaminimin tërheqjen e fotove-dëshmimeve të telefonit të viktimës, nëse po kur e keni pranuar?*”
12. Avokati i Popullit, në bazë të hetimit të zhvilluar, ka konstatuar se më 22 qershor 2022 Policia kishte filluar me veprimet hetimore për identifikimin e elementeve të veprës penale të trafikimit me njerëz, përkatësisht të fëmijës, ndërsa rasti i dytë, ku viktimat ishin të njëjti fëmijë, më 28 gusht 2022 në Polici ishte iniciuar rasti: “*Dhunim seksual me nr. 2022-AC-1280*”, me ç’ rast fëmija, pas procedurave policore, me referim të QPS-së ishte dërguar në një strehimore.

### **Përgjigjet e institucioneve shtetërore**

13. Më 16 shtator 2022, përfaqësuesi i IAP-së kishte marrë nga përfaqësuesja e QPS-së një kopje të dosjes së rastit (në tekstin e mëtejme: dokumentacioni i çështjes në QPS).
14. Më 28 shtator 2022, IAP-ja kishte marrë nga ZMNV-ja një kopje të dosjes së rastit (në tekstin e mëtejme: dokumentacioni i çështjes në ZMNV).
15. Më 30 shtator 2022, IAP-ja kishte marrë nga Policia një kopje të dosjes së rastit (në tekstin e mëtejme: dokumentacioni i çështjes në Polici).
16. Më 10 nëntor 2022, IAP-ja kishte marrë përgjigje nga AKF-ja: “***I. Funksonimi dhe veprimtaria*** Agjencia e Kosovës për Forenzikë funksionimin dhe veprimtarinë e saj e ka të rregulluar me ligj të veçantë nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë”. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, nr. 08/L-032, neni 134 “*Nëse ndonjë lloj i caktuar i ekspertizës i përgjigjet fushës së ndonjë institucioni profesional apo ekspertimi mund të bëhet brenda një organi publik të caktuar. kjo detyrë, posaçërisht nëse është detyrë e ndërlikuar, si rregull i besohet institucionit të tillë profesionale apo organit publik. Institucioni profesional apo organi publik cakton një apo disa ekspertë për të kryer ekspertimin*”. ***II Afatet për kryerje të ekspertimit*** Neni 19 i ligjit Nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë “*AKF është e obliguar që të kryej me kohë ekspertizën e dëshmisë dhe krahas dëshmisë, dosjes t’ia bashkëngjij raportin gjithëpërfshirës, në të cilin duhet të jepet mendimi profesional lidhur me ekspertizën e kryer.*”
17. Më 7 dhjetor 2022, IAP-ja kishte marrë përgjigje nga Prokuroria: “[...] Më datë 20.09.2022, kemi pranuar përgjigje nga Instituti i Mjekësisë Ligjore (IML), Ministria e



*Drejtësisë, (i pranuar në formë fizike), në bazë të vendimit të Prokurorisë RN.M.20, të datës 22.06.2022. Më datë 01.09.2022, kemi pranuar përgjigje nga Agjencia Kosovare për Forenzikë (AKF), në bazë të vendimit të Prokurorisë RN.M.20/22, të dt. 24.06.2022. Më datë 07.11.2022 kemi pranuar përgjigje nga Agjencia Kosovare për Forenzikë (AKF), në bazë të urdhëresës së Prokurorisë, me nr. RN.M.20/22, të dt. 23.06.2022 [...].”*

## **Përmbledhja e fakteve sipas dokumentacionit të Qendrës për Punë Sociale**

18. Më 22 qershor 2022<sup>6</sup>, sipas dokumentacionit të çështjes në QPS, ky institucion ishte informuar për rastin nga Policia, Tutje në këtë shkresë<sup>7</sup> thuhej se më 22 qershor 2022, në orën 19:30, në Qendrën për Strehimin, Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Viktimave të Trafikimit me Qenie Njerëzore (në tekstin e mëtejme: Strehimorja), nën përcjellje të Policisë ishte bërë strehimi i fëmijës, meqenëse vlerësimi fillestar i rrezikut ishte i lartë. Tutje nga QPS-ja thuhej se nga ajo çfarë fëmija kishte treguar, ishte kuptuar se ishte viktimë potenciale e trafikimit dhe, me urdhëresë të prokurorit të shtetit, i ishte bërë ekzaminimi mjekësor dhe më pas ishte vendosur në strehimore. Po ashtu, sipas dokumentacionit të çështjes<sup>8</sup>, thuhej se viktima, më 21 qershor 2022, ishte raportuar person i zhdukur.
19. Më 23 qershor 2022<sup>9</sup>, QPS-ja e kishte njoftuar Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, përkatësisht Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes, se fëmija ishte dërguar në strehimore, meqenëse vlerësimi fillestar i rrezikut ishte i lartë.
20. Më 24 qershor 2022<sup>10</sup>, Grupi për Ndihmë Direkte (GND) kishte mbajtur takimin e parë ku ishte biseduar rreth vlerësimit të nevojave dhe ofrimin e shërbimit për fëmijën. Si çështje e domosdoshme kishte dalë që fëmija të përcillej nga një psikologe për mbajtjen e seancave psikologjike me fëmijën. Pjesë e këtij ekipi kishte qenë edhe psikologu. GND-ja kishte mbajtur gjithsej shtatë takime, krahas rrethanave të tjera ishte vlerësuar edhe gjendja emocionale e fëmijës pas shfaqjes tej mase të dëshirës dhe kërkesave të vazhdueshme të saj për t’u kthyer te prindërit.
21. Më 27 qershor 2022, në QPS ishin dhënë deklaratat e prindërve në lidhje me çështjen, përkatësisht me situatën e ndodhur. Po ashtu prindërit e fëmijës kishin dhënë pëlqimin<sup>11</sup> që vajza e tyre të strehohej në strehimore duke e vlerësuar interesin me të lartë të fëmijës, gjersa Policia t’i zhvillonte procedurat e nevojshme. Tutje sipas dokumentacionit të çështjes<sup>12</sup>, prindërit e fëmijës kishin dhënë deklaratë dhe kishin kërkuar që vajza e tyre të kthehej në shtëpi te prindërit, të cilët edhe kishin planifikuar pushimin veror familjar. Sipas QPS-së, prindërit edhe me herët, po thuajse në baza ditore, kishin kërkuar me vendosmëri që fëmija të largohet nga strehimorja, sepse, sipas tyre, qëndrimi në strehimore nuk ishte i përshtatshëm për moshën e vajzës dhe se ajo në shtëpi do të ishte në përkujdesjen e shtuar dhe përgjegjësive të tyre prindërore. Përveç prindërve, edhe fëmija kishte kërkuar të kthehej në shtëpi.<sup>13</sup>

<sup>6</sup> QPS- Forma 001, paraqitja e rastit.

<sup>7</sup> Kategoria e shfrytëzuesit Trafikim.

<sup>8</sup> PK- Forma Bazike e të dhënave për viktimat e Trafikimit.

<sup>9</sup> QPS-Njoftim, nr.prot.831.

<sup>10</sup> QPS- Forma 005, Fleta përcjellës e kontaktit dhe puna me rast.

<sup>11</sup> QPS- Nr. prot. 871, datë 30.6.2022, dhe Nr.prot.839, datë 27.6.2022.

<sup>12</sup> QPS- Nr. Prot. 962 dhe nr. prot 973.

<sup>13</sup> Forma 8-Deklarata për largim vullnetar.



22. Më 28 qershor 2022<sup>14</sup> ishte mbajtur seanca e parë psikologjike, me pas kishin pasuar edhe seancat e tjera psikologjike. Më 4 korrik 2022 ishte mbajtur seanca e dytë psikologjike, më 13 korrik 2022 ishte mbajtur seanca e tretë psikologjike dhe më 28 korrik 2022 ishte mbajtur seanca e katërt psikologjike.
23. Më 29 qershor 2022, QPS-ja ia kishte dërguar Policisë raportin mbi dëgjimin e fëmijës.<sup>15</sup>
24. Më 30 qershor 2022<sup>16</sup> ishte realizuar takimi i fëmijës me prindërit, pas insistimit të prindërve dhe të fëmijës që të realizohej kontakti.<sup>17</sup>
25. Më 4 korrik 2022, nga psikologia (Labyrinth) ishte përgatitur raporti i vlerësimit psikologjik për fëmijën. Strehimorja, nëpërmjet IOM-it, e kishte siguruar psikologun.
26. Më 21 korrik 2022<sup>18</sup>, sipas strehimores, rasti në fjalë ishte pranuar në gjendje të mirë shëndetësore. Gjatë qëndrimit, pos të tjerash, viktima kishte mbajtur seanca psikologjike.
27. Më 21 korrik 2022<sup>19</sup> ishte mbajtur takimi me përfaqësuesit e strehimores, të QPS-së, të Policisë dhe me psikologun. Në këtë takim QPS-ja kishte njoftuar se kishin pasur takime me prindërit e viktimës, të cilët kishin kërkuar që fëmija të kthehej në familje. **Policia kishte njoftuar se rreziku i saj vazhdonte të ishte i njëjtë, pra kishte treguar se vlerësimi i rrezikut ishte i lartë.** Po ashtu, QPS-ja kishte njoftuar se kishte marrë edhe pëlqimin e prokurorit, i cili ishte pajtuar që vajza të transferohej në familje nëse prindërit e pranonin me të njëjtat rrethana. Fëmija kishte mbajtur edhe seancën psikologjike të radhës dhe, sipas psikologes, ajo dëshironte t'i vazhdonte seancat edhe pas largimit nga qendra. Sipas shkresave, fëmija ishte e kënaqur që po kthehej në shtëpi. Pra në të njëjtën ditë<sup>20</sup>, me kërkesën e prindit dhe në koordinim e në konsultim me prokurorin e çështjes, vajza ishte kthyer në familje. Prindi ishte njoftuar për vlerësimin se rreziku ishte i lartë.
28. Më 28 korrik 2022<sup>21</sup>, GND-ja kishte mbajtur takimin e radhës si dhe ishte realizuar seanca e radhës me psikologun.
29. Më 17 gusht 2022<sup>22</sup>, nëna e fëmijës e kishte informuar QPS-në se ishin kthyer nga pushimi vjetor. Po ashtu QPS-ja, më 23 dhe më 25 gusht 2022, kishte pasur komunikim me psikologun lidhur me organizimin e seancës psikologjike, të cilën e kishte njoftuar se fëmija ishte kthyer nga pushimi dhe ishte i gatshëm për seancën e radhës.

### **Përmbledhja e fakteve sipas dokumentacionit të Policisë**

30. Më 22 qershor 2022, sipas dokumentacionit të çështjes në Polici<sup>23</sup>, rreth orës 1:00, nëna e viktimës e ka informuar Policinë se vajza e saj ishte larguar nga shtëpia dhe nuk ishte kthyer si dhe kishte dhënë deklaratë lidhur me zhdukjen e saj.
31. Më 22 qershor 2022, Policia kishte kërkuar nga Prokuroria të bëhej ekzaminimi fiziko-gjinekologjik.<sup>24</sup> Në të njëjtën ditë Prokuroria kishte marrë vendim me të cilin e kishte

<sup>14</sup> QPS- Forma 005, Fleta përcjellës e kontaktit dhe puna me rast.

<sup>15</sup> Shkresa nr.858, datë 29.6.2022.

<sup>16</sup> PK- formulari i vizitës të viktimës së trafikuar.

<sup>17</sup> QPS- Forma 005, Fleta përcjellëse e kontaktit dhe puna me rast.

<sup>18</sup> Strehimorja- Forma e transferit/lëshimit nga strehimorja.

<sup>19</sup> Takimet me GND; QPS. Forma 005, Fleta përcjellës e kontaktit dhe puna në rast.

<sup>20</sup> PK- Forma e pranim-dorëzimit të viktimave.

<sup>21</sup> PK-Formular i vizitës të viktimave e trafikimit.

<sup>22</sup> QPS-Forma 005, Fleta përcjellëse e kontaktit dhe puna me rast.

<sup>23</sup> PK-Procesverbal mbi intervistimin e dëshmitarit, 22.6.2022.



- obliguar Institutin e Mjekësisë Ligjore (IML) ta bënte ekzaminimin fiziko-gjinekologjik të së dëmtuarës, duke e kategorizuar këtë shkresë si të natyrës urgjente.
32. Më 23 qershor 2022, Policia kishte kërkuar nga Prokuroria ta urdhëronte AKF-në ta kryente ekzaminimin e ADN-së si dhe të bëhej krahasimi i dëshmime të cekura në shkresë, të cilat janë marrë gjatë ekzaminimit nga IML-ja.<sup>25</sup> Në të njëjtën ditë Prokuroria kishte lëshuar urdhëresë për ekzaminimin e ADN-së<sup>26</sup>, duke e kategorizuar këtë shkresë si të natyrës urgjente.
33. Më 24 qershor 2022, Policia kishte parashtruar në Prokurori kërkesën për sekuestrim të përkohshëm dhe ekzaminim të telefonit të viktimës.<sup>27</sup> Prokuroria, mbi bazën e kërkesës së Policisë, kishte lëshuar vendim që AKF-ja, Sektori për fotografi, video analizë dhe ekzaminim të TI-së, ta bënte ekzaminimin dhe tërheqjen e fotove-dëshmime të telefonit të viktimës, duke e kategorizuar këtë vendim të natyrës urgjente.
34. Më 24 qershor 2022, Gjykata Themelore në Prishtinë (në tekstin e mëtejme Gjykata)<sup>28</sup> kishte lëshuar Urdhëresë për sekuestrimin e përkohshëm të telefonit, pronë e së dëmtuarës, sipas kërkesës së Prokurorisë, datë 24 qershor 2022.
35. Më 27 qershor 2022, Policia kishte parashtruar kërkesë në Prokurori për tërheqjen e video-incizimeve dhe kontrollimin e evidencave të vizitorëve në motelin përkatës.<sup>29</sup> Lidhur me këtë, Prokuroria kishte lëshuar urdhëresë.<sup>30</sup>
36. Më 29 qershor 2022, sipas dokumentacionit të çështjes së Policisë<sup>31</sup>, përmendeshin disa persona si të dyshuar për kryerje të veprave penale si dhe disa prova materiale, të cilat ishin dërguar për ekzaminim në AKF.
37. Më 4 korrik 2022, Policia kishte njoftuar Prokurorinë për zbatimin e Urdhëresës nr. RNM, nr.20/2020, lidhur me çështjen e motelit përkatës.
38. Më 7 korrik 2022 ishte përpiluar procesverbali mbi dëgjimin e dëshmitarit të dëmtuar. Të pranishëm ishin: e dëmtuara, përfaqësuesi i QPS-së, psikologja, mbrojtësi i viktimave, zyrtari ligjor dhe prokurori i shtetit.
39. Më 12 korrik 2022, Policia kishte marrë në pyetje të dyshuarin.<sup>32</sup>
40. Më 30 gusht 2022, AKF-ja<sup>33</sup> ia kishte dërguar Prokurorisë ekzaminimin e tërheqjes së fotove-dëshmime të telefonit të viktimës.
41. Sipas dokumentacionit të Policisë<sup>34</sup>, thuhet se më 1 shtator 2022 nga AKF-ja ishte pranuar raporti i ekspertimit të telefonit celular së bashku me materialin, në formë elektronike (DVD), që kishte siguruar ekzaminimin e telefonit të viktimës.

---

<sup>24</sup> PK-Kërkesë për ekzaminimin fiziko-gjinekologjik, 23.6.2022, kërkesë e natyrës urgjente.

<sup>25</sup> PK-Kërkesë për ekzaminimin e mostrave, 23.6.2022, kërkesë e natyrës urgjente.

<sup>26</sup> PThP-Urdhëresë për ekzaminimin e ADN, 23.6.2022.

<sup>27</sup> PK-Kërkesë për sekuestrim të përkohshëm dhe ekzaminim të telefonit, 24.6.2022, kërkesë e natyrës urgjente.

<sup>28</sup> GjThP: PMN1.nr. 14/2022.

<sup>29</sup> PK-Kërkesë për tërheqjen e video-incizimeve dhe kontrollimin e evidencave të vizitorëve, 27.6.2022, kërkesë e natyrës urgjente.

<sup>30</sup> PThP-RNM.nr.20/2022, datë 27.6.2022.

<sup>31</sup> PK-Raport njoftues, 29.6.2022.

<sup>32</sup> PK-Procesverbali, 27.6.2022.

<sup>33</sup> AKF- Raport të ekspertimit për PThP-në.

<sup>34</sup> PK-Raport njoftues për PThP, datë 21.9.2022.



## Përmbledhja e fakteve sipas dokumentacionit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave

42. Sipas dokumentacionit të çështjes të në Zyrën për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave (ZMNV), më 22 qershor 2022 ZMNV-ja ishte njoftuar nga Policia lidhur me rastin dhe menjëherë kishin shkuar në stacionin policor dhe në praninë e Policisë kishin zhvilluar një bashkëbisedim të shkurtër me viktimën e mitur. Tutje, mes të tjerash, thuhej se për shkak të rrezikshmërisë së lartë, përfaqësuesi i ZMNV-së e kishte plotësuar formën bazike të të dhënave për viktimën e trafikimit, që i ishte ofruar nga Policia. Gjithashtu ZMNV-ja ishte ftuar t'i bashkohej grupit direkt për mbështetje. Sipas ZMNV-së, intervistimi i së miturës kishte ndodhur më 7 korrik 2022 dhe kishte qenë në rregull.

### Instrumentet relevante ligjore lidhur me çështjen

43. Ekzistojnë një varg instrumentesh ligjore që e rregullojnë këtë çështje, por pa u kufizuar te Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila në nenin 21, paragrafi 1, përcakton: *“Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.”* Paragrafi 2 i këtij neni: *“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë.”* Po ashtu, paragrafi 3 thotë: *“Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”*
44. Më tej, Kushtetuta në nenin 50 (Të Drejtat e Fëmijës) përcakton: *“1. Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre.”* Ndërsa paragrafi 3 i këtij neni thotë: *“Secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.”* Kurse paragrafi 4 i këtij neni thotë: *“Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërrmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.”* Kushtetuta në nenin 25 (E Drejta për Jetën), paragrafi 1, përcakton: *“Secili individ gëzon të drejtën për jetën.”* Më tutje, neni 29 (e drejta e lirisë dhe sigurisë) përcakton: *“Secilit i garantohet e drejta e lirisë dhe sigurisë.”*
45. Kushtetuta në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] përcakton: *“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*
46. Kushtetuta në nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] përcakton: *“Të drejtat dhe liritë e garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (...) (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj (...) (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijë. (8). Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (9) Konventa e Këshillit të Europës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje.”*
47. Konventa për të Drejtat e Fëmijës (në tekstin e mëtejshëm: KDF), në nenin 3, paragrafi 1, përcakton: *“Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet*



*administrative apo organet legislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”*

48. Konventa për të Drejtat e Fëmijës, në nenin 19 përcakton: “1. Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, **përfshirë abuzimin seksual**, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar. (...)”
49. KDF-ja në nenin 34 përcakton: “Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. (...)”
50. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje (në tekstin e mëtejme: Konventa e Stambollit), e cila ka për qëllim mbrojtjen e grave nga të gjitha format e dhunës, parandalimin, ndjekjen penale dhe eliminimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, zbatohet për të gjitha format e dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën seksuale, dhe se përkufizimi “gra” në Konventë përfshin edhe vajzat nën 18 vjeçe.<sup>35</sup>
51. Konventa e Stambollit, në nenin 5, paragrafi 2, obligon: “Palët marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera të nevojshme për të ushtruar masa paraprake për të parandaluar, hetuar, dënuar dhe siguruar kompensim për akte dhune të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente, të cilat kryhen nga aktorë joshitetërorë.”
52. Për më tepër, Konventa në nenin 26 parasheh “1. Palët marrin masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të garantuar që në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes dhe mbështetjes së viktimave, të merren në konsideratë të drejtat dhe nevojat e dëshmitarëve fëmijë(...). 2. Masat e marra sipas këtij neni përfshijnë këshillimin e dëhur psikosocial për dëshmitarët fëmijë të të gjitha formave të dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente dhe marrin në konsideratë interesat më të mira të fëmijës.”
53. Përveç të tjerash, Konventa e Stambollit në nenin 56, paragrafi 1, obligon shtetin të ndërmarrë një mori masash të nevojshme legislative apo masa të tjera, varësisht nga nevojat e veçanta të viktimës, për t’i mbrojtur të drejtat dhe interesat e saj, në të gjitha fazat e hetimeve dhe të procedimeve gjyqësore, në veçanti duke ofruar mbrojtjen e saj nga kërcënimi dhe nga viktimizimi i përsëritur.
54. Kodi nr. 06/l-074 Penal i Republikës së Kosovës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr.2/14 janar 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Kodi Penal), përcakton veprat penale dhe sanksionet penale<sup>36</sup> për ato sjellje me të cilat cenohen apo dëmtohen në atë masë liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe të drejtat e tjera dhe vlerat shoqërore të garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutë dhe me të drejtën ndërkombëtare, mbrojtja e të cilave nuk do të mundë të realizohet pa sanksione penale të shtetit ligjor.
55. Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/ nr. 37/28 dhjetor 2012, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: KPP), pos të tjerash, përcakton rregullat e procedurës penale, të cilat janë të detyrueshme për punën e gjykatave, të

<sup>35</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës kundër grave dhe dhunës në familje, nenet 1.1(a), 2.1 dhe 3 (a, f), 2011, në: <https://rm.coe.int/168046246b>

<sup>36</sup> Kodi Penal, Kapitullin XX (Veprat penale kundër integritetit seksual), por pa u kufizuar në të.



prokurorisë së shtetit, si dhe të pjesëmarrësve të tjerë në procedurën penale të paraparë me këtë Kod.<sup>37</sup>

56. Kodi nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 17/18 tetor 2018, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: KDM), në nenin 2 (Fushëveprimi) përcakton: *“Ky Kod rregullon veprimin ndaj të miturit si kryes i veprës penale, fëmijët e përfshirë dhe të miturit si pjesëmarrës në procedurë, organeve të cilat zbatojnë procedurën penale dhe ekzekutimin e masave dhe dënimeve ndaj kryesit të mitur të veprës penale, si dhe mbrojtjen e personave të mitur dhe fëmijëve të cilët janë viktimë dhe të dëmtuar nga vepra penale.”*
57. Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 34/4 shtator 2013, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: LPLTNjMVT) parasheh dispozita specifike kur viktimat janë fëmijë.
58. Ligji nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: viti v/nr. 83/29 tetor 2010, në nenin 7, pos të tjerash ka përcaktuar *“ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale”* si dhe *“ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.”*
59. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 04/ 19 mars 2012, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: Ligji për Policinë), rregullon autorizimet dhe detyrat e Policisë së Republikës së Kosovës, organizimin e saj dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Policisë së Republikës së Kosovës.
60. Ligji nr. 06/l-084 për Mbrojtjen e Fëmijës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/nr. 14/17 korrik 2019, Prishtinë (në tekstin e mëtejme: LMF), ka për qellim, pos të tjerash: *“Ta mbrojë fëmijën nga të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, nga abuzimi, keqpërdorimi, shfrytëzimi, neglizhimi, apo nga ndonjë formë tjetër që e vë në rrezik jetën, sigurinë, shëndetin, edukimin, arsimimin dhe zhvillimin e fëmijës.”*, duke marrë për bazë parimet për mbrojtjen e tij, si: të drejtën për jetë; për mbijetesë dhe zhvillim; për interesin më të mirë të fëmijës; për zhvillimin gradual të tij; për respektimin e pikëpamjes së tij dhe për mosdiskriminim.

## Analiza

### A. Përbushja e obligimeve për mbrojtjen e fëmijës nga rreziku sipas standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijës

61. Kushtetuta mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, përfshirë edhe të drejtat e fëmijës. Zbatimi dhe realizimi në praktikë i këtyre të drejtave është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës. Kushtetuta shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha institucioneve që t'i respektojnë liritë dhe të drejtat e njeriut,<sup>38</sup> dhe në rastet kur kemi të bëjmë me një fëmijë, të gjitha veprimet e ndërmarra nga këto institucione duhet të jenë në interesin më të mirë të tij/saj.

<sup>37</sup> Në këtë raport i referohemi këtij Kodi. Më 17 gusht 2022 është publikuar në GZRK Kodi nr. 08/L-032 i Procedurës Penale, i cili në nenin 546 ka përcaktuar (Hyrja në fuqi): *“Ky Kod hyn në fuqi gjashtë (6) muaj pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, përveç nenit 25, paragrafët 3 dhe 4 të këtij Kodi që fillojnë të zbatohen dy (2) vjet pas hyrjes në fuqi të këtij Kodi.”*

<sup>38</sup> Kushtetuta, neni 21.



62. Kushtetuta, pos të tjerash, parasheh se secili person e ka të drejtën e respektimit të integritetit fizik të tij/saj<sup>39</sup>, ku kjo e drejtë ngërthen detyrime pozitive për shtetin për t'i ndërmarrë të gjitha masat për ta mbrojtur pacenueshmërinë e saj. Kushtetuta e garanton dhe e konkretizon këtë të drejtë edhe me dispozitat e tjera, këtu mes të tjerash hyjnë edhe dispozitat kushtetuese për ndalimin e torturës, trajtimit mizor, jonjerëzor dhe poshtërues.<sup>40</sup> Më tutje, Kushtetuta përcakton së fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre dhe se secili fëmijë gëzon të drejtën për të qenë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi dhe eksploatimi.<sup>41</sup> Kjo e drejtë përfshin edhe mbrojtjen nga **dhuna dhe abuzimi seksual**. Rrjedhimisht, organet shtetërore obligohen për ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për ta siguruar mbrojtjen e fëmijës nga abuzimet dhe keqpërdorimet, si dhe mbrojtje të tjera në të gjitha fushat e jetës, që janë në interes të mirëqenies së tij/saj. Për më tepër, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj).
63. Në bazë të praktikës së GjEDNj-së, rastet lidhur me veprat e dhunimit dhe të trafikimit me qenie njerëzore mbulohen kryesisht në kuadër të nenit 3 - *Ndalimi i torturës*, dhe të nenit 4 - *Ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar* - të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj). Në rastin e *V. C. kundër Italisë*, Gjykata ka ritheksuar se shtetet palë kanë për detyrim që, sipas nenit 1 të Konventës, brenda juridiksionit të tyre t'u sigurojnë të gjithëve të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë. Më tutje, lexuar së bashku me nenin 3 të Konventës, shtetet kanë për detyrë të ndërmarrin masa të parashikuara për të siguruar që individët brenda juridiksionit të tyre nuk i nënshtrohen keqtrajtimit, duke përfshirë keqtrajtimin e administruar nga individë privatë.<sup>42</sup> Këto masa duhet të ofrojnë: *“Mbrojtje efektive, në veçanti të fëmijëve, të cilët janë veçanërisht të cenueshëm (ndjeshëm) ndaj formave të ndryshme të dhunës, dhe të përfshijnë hapa të arsyeshëm për të parandaluar keqtrajtimet për të cilat autoritetet kishin ose duhej të kishin njohuri, si dhe parandalimin efektiv për mbrojtjen e të miturve kundër shkeljeve të tilla serioze të integritetit personal. Masa të tilla duhet të synojnë garantimin e respektimit të dinjitetit njerëzor dhe mbrojtjen e interesave më të mira të fëmijës.”*<sup>43</sup>
64. Në rastin e *M. C. kundër Bullgarisë*, gjykata ka vlerësuar se shtetet kanë një detyrim pozitiv, që buron nga nenet 3 - *Ndalimi i torturës* dhe 8 - *E drejta e respektimit të jetës familjare dhe private* - të Konventës për të miratuar dispozita të ligjit penal që ndëshkojnë në mënyrë efektive dhunimin dhe t'i zbatojnë ato në praktikë nëpërmjet hetimit dhe ndjekjes penale efektive.<sup>44</sup> Sipas Gjykatës, qëllimi i detyrimit pozitiv për mbrojtje nën nenin 3 duhet të interpretohet në atë mënyrë që *“nuk imponon një barrë të pamundur ose joproporcionale për autoritetet, gjithmonë duke pas parasysh vështirësitë që ekzistojnë mbarëvajtjen e ligjit dhe rendit në shoqëritë moderne, paparashikueshmërinë e sjelljes njerëzore dhe zgjedhjet operationale që duhen bërë në aspektin e prioriteteve dhe burimeve.”*<sup>45</sup> Po në rastin *M. C. kundër Bullgarisë*, GjEDN-ja ka theksuar se në rastet e

<sup>39</sup> Kushtetuta, neni 26.

<sup>40</sup> Kushtetuta, neni 27.

<sup>41</sup> Kushtetuta, neni 50, para.1 dhe 3.

<sup>42</sup> V.C. kundër Italisë, 2018, në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%5B%22001-180719%22%5D%7D>

<sup>43</sup> Po aty, paragrafi 89.

<sup>44</sup> M.C. kundër Bullgarisë, 2004, në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22%3A%5B%22001-61521%22%5D%7D>

<sup>45</sup> V.C. kundër Italisë, paragrafi 90.



abuzimit seksual, fëmijët janë veçanërisht të cenueshëm. Po ashtu, e drejta për dinjitet njerëzor dhe integritet psikologjik kërkon vëmendje të veçantë kur një fëmijë është viktimë e dhunës.<sup>46</sup>

65. Prandaj, në rastet e këtilla, ato duhet të shqyrtohen në kuadër të neneve 3 dhe 8 të Konventës, sepse të dyja sjellin detyrimin e shtetit për ta mbrojtur integritetin fizik dhe psikologjik të një personi. Natyrisht, fëmijët dhe individët e tjerë të cenueshëm, në veçanti, kanë të drejtë për mbrojtje efektive.
66. Që të lindë një detyrim pozitiv për autoritetet nën nenin 3 të KEDNj-së, atëherë duhet të vërtetohet se autoritetet (1) e dinin ose duhej ta dinin në kohën e ekzistencës së një rreziku real dhe të menjëhershëm të keqtrajtimit të një individi të identifikuar nga veprimet kriminale të një pale të tretë dhe se (2) ata nuk arritën të merrnin masa brenda fushës së kompetencave të tyre, të cilat, gjykuar në mënyrë të arsyeshme, mund të pritej ta shmangnin këtë rrezik.<sup>47</sup>
67. Lidhur me mbrojtjen e integritetit fizik dhe psikologjik të një individi nga persona të tjerë, ky aspekt i detyrimit pozitiv nuk kërkon domosdo një vendim gjyqësor pozitiv, por zbatim efektiv të ligjit, veçanërisht atij penal, për ta siguruar mbrojtjen e të drejtave të garantuara nga neni 3 i Konventës (shih *M.G. kundër Turqisë*, nr. 646/ 10, § 80, 22 mars 2016). Një kërkesë për shpejtësi dhe veprime të arsyeshme është e nënkuptuar në detyrimin për të kryer një hetim. Makineria e mbrojtjes, e parashikuar në ligjin e brendshëm, duhet të funksionojë në praktikë brenda një kohe të arsyeshme për ta përfunduar shqyrtimin mbi themelin e çështjeve specifike të paraqitura tek autoritetet (shih *Opuz kundër Turqisë*, §§ 150-51). Detyrimi i shtetit, sipas nenit 3 të Konventës, nuk do të konsiderohet i përmbushur nëse mbrojtja e ofruar nga ligji i brendshëm ekziston vetëm në teori: mbi të gjitha, ai duhet të funksionojë në mënyrë efektive edhe në praktikë, dhe kjo kërkon një shqyrtim të shpejtë të çështjes pa vonesa të panevojshme.<sup>48</sup>
68. KDF-ja, si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar në fushën e të drejtave të fëmijës, ka paraparë gjithashtu se obligimi i shteteve për t'i marrë të gjitha masat e mundshme për të siguruar mbijetesën dhe zhvillimin e fëmijës përbën jo vetëm një nga të drejtat themelore të Konventës<sup>49</sup>, por edhe një ndër katër parimet kryesore në interpretimin dhe zbatimin e saj.<sup>50</sup> Sipas Komitetit të KDF-së, shtetet duhet ta interpretojnë “zhvillimin e fëmijës” në kuptimin e tij më të gjerë si një koncept gjithëpërfshirës, që nënkupton zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe shoqëror të fëmijës.<sup>51</sup> Në veçanti, Konventa parasheh obligimet e shtetit në marrjen e të gjitha masave të përshtatshme legjislativë, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga **abuzimin seksual**. Këto masa përfshijnë, ndër të tjerash, edhe parandalimin, identifikimin, raportimin, referimin, **hetimin**, trajtimin dhe ndjekjen e rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, qoftë nëpërmjet proceseve gjyqësore.<sup>52</sup> Mënyra e formulimit të këtij obligimi nuk le hapësirë për diskrecion të lirë të shteteve dhe shtetet kanë një

<sup>46</sup> C.A.S. dhe C.S. kundër Rumanisë, 2012, paragrafi 82, në: <https://hudoc.echr.coe.int/eng#%7B%22itemid%22:%5B%22001-109741%22%5D%7D>

<sup>47</sup> Po aty.

<sup>48</sup> Po aty, paragrafët 91-95.

<sup>49</sup> KDF, neni 6.

<sup>50</sup> Shih Komentin e Përgjithshëm Nr.5 të Konventës të miratuar nga Komiteti i KDF-së, në: <https://www.refworld.org/docid/4538834f11.html>.

<sup>51</sup> Po aty, para. 12.

<sup>52</sup> Po aty, neni 19.



detyrim të rreptë të ndërmarrin “gjithçka që është masë e përshtatshme” për ta zbatuar plotësisht këtë të drejtë për të gjithë fëmijët.<sup>53</sup> Për më tepër, personat përgjegjës për referimin e rasteve të dhunës kundër fëmijëve duhet të jenë profesionistë të trajnuar, të cilët japin një vlerësim shumëdisiplinor për nevojat afatgjata dhe afatshkurtra të fëmijës, të kujdestarëve dhe të familjes, i cili përfshin dhe i jep peshë të duhur pikëpamjeve të fëmijëve si dhe të familjes, referon fëmijën dhe familjen te një sërë shërbimesh për t’i përmbushur ato nevoja; përcjell dhe vlerëson përshtatshmërinë e intervenimit.<sup>54</sup> Hetimi po ashtu duhet të ndërmerret nga profesionistë të kualifikuar bazuar në të drejtat e fëmijëve dhe me qasje të ndjeshme ndaj fëmijëve. Duhet pasur kujdes të veçantë që fëmija të mos viktimizohet më tutje.<sup>55</sup> Trajtimi i këtyre rasteve nënkupton ofrimin e shërbimeve mjekësore, të shëndetit mendor, sociale dhe ligjore, si dhe të shërbimeve përcjellëse afatgjata.

69. Konventa thekson obligimin e autoriteteve shtetërore për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e shfrytëzimit seksual dhe të keqtrajtimit seksual, si dhe shitjes dhe të tregimit të fëmijëve me çfarëdo qëllimi dhe me çfarëdo forme.<sup>56</sup> Po ashtu, Komiteti i KDF-së tërheq vëmendjen se dhuna shpesh ka një komponent gjinor. Për shembull, vajzat mund të përjetojnë më shumë dhunë seksuale në shtëpi sesa djemtë, ndërsa djemtë kanë më shumë gjasa të ndeshen dhe të përjetojnë dhunë brenda sistemit të drejtësisë penale. Andaj, shtetet palë duhet të sigurojnë që politikat dhe masat e ndërmarra kanë parasysh rreziqet e ndryshme me të cilat përballen vajzat dhe djemtë në lidhje me forma të ndryshme të dhunës në mjedise të ndryshme.<sup>57</sup>
70. Konventa e Stambollit, si instrumenti më i rëndësishëm në fushën e parandalimit dhe të luftimit të dhunës ndaj grave dhe vajzave, parasheh: “*Dhunë me bazë gjinore ndaj grave*” do të thotë dhunë që drejtohet ndaj një gruaje (apo vajze) për shkak se ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë joproporcionale.”<sup>58</sup> Konventa obligon shtetin të ndërmarrë masa legislative dhe masa të tjera për mbrojtje dhe mbështetje të fëmijëve viktimat dhe/apo dëshmitarë, përfshirë këshillimin e duhur psiko-social dhe duke marrë në konsideratë interesat më të mira të fëmijës. Gjithashtu, varësisht nga nevojat e veçanta të viktimës, shtetet obligohen të ndërmarrin masa në të gjitha fazat e hetimeve dhe të procedimeve gjyqësore, në veçanti për ta mbrojtur viktimën nga kërcënimi dhe nga viktimizimi i përsëritur.<sup>59</sup> Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe nga dhuna ndaj grave, për vitet 2022-2026, tregon se gratë dhe vajzat janë më të ekspozuara sesa burrat dhe djemtë ndaj një rreziku më të lartë të dhunës në baza gjinore.<sup>60</sup> Sipas Raportit të EULEX-it, nga viti 2019-2021, në 85% të rasteve, viktimat e dhunimit ishin vajza nën

<sup>53</sup> Komiteti i KDF-së, Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 (2011) E drejta e fëmijës për liri nga të gjitha format e dhunës, par. 37, në: <https://www.refworld.org/docid/4e6da4922.html>.

<sup>54</sup> Po aty, par. 50.

<sup>55</sup> Po aty, par. 51.

<sup>56</sup> KDF, neni 33 dhe 34.

<sup>57</sup> Komenti i Përgjithshëm Nr. 13, paragrafët 19 dhe 72.

<sup>58</sup> Konventa e Stambollit, neni 3(d).

<sup>59</sup> Po aty, nenet 26 dhe 56.

<sup>60</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia kombëtare për mbrojtje nga dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave 2022-2026, 2022, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/05/ALB-Strategjia-Kombe%CC%88tare-pe%CC%88r-Mbrojtje-nga-Dhuna-ne%CC%88-Familje-dhe-Dhuna-ndaj-Grave-2022-%E2%80%93-2026.pdf>



moshën 18 vjeçe, ndërsa të gjithë kryerësit ishin burra.<sup>61</sup> Ngjashëm, në vitin 2021, 75% e viktimave të trafikimit ishin gra dhe vajza dhe shumica nën moshën 18 vjeçe.<sup>62</sup> Këto të dhëna reflektojnë dimensionin gjinor të dhunës, ku dhuna seksuale paraqitet si formë e dhunës në baza gjinore dhe ku vajzat janë në rrezik më të madh nga kjo formë e dhunës. Më tutje, detyrimet e shtetit për mbrojtjen e fëmijës shihen si të dyfishta duke qenë se bëhet fjalë për një grup të cënueshëm ndaj dhunës, pra për fëmijën vajzë.

71. LMF-ja ka paraparë ndërmarrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e rreziqeve ndaj mirëqenies së fëmijës, ku parandalimi përfshin perceptimin e situatave dhe të ngjarjeve që kërcënojnë fëmijën, sa më shpejt të jetë e mundur dhe reagimin e tyre, duke përfshirë, ndër të tjerash, identifikimin e abuzimit dhe rritjen e masave mbrojtëse. Për më tepër, masat duhet të jenë të arritshme, me kohë dhe të kenë një efekt pozitiv afatgjatë.<sup>63</sup>
72. Bazuar në atë që u tha më lart, Avokati i Popullit vlerëson se ekziston një detyrim pozitiv për autoritetet shtetërore për të marrë masa operacionale dhe parandaluese për mbrojtjen e fëmijës, jeta e të cilit është në rrezik nga aktet kriminale të një apo më shumë personave të tjerë.
73. Avokati i Popullit vëren se rasti i fëmijës viktimë është trajtuar dhe adresuar nga përfaqësues të insitacioneve përgjegjëse në një qasje shumëdisiplinore, në pajtim me kërkesat e KDF-së, që përfshijnë: Policinë, QPS-në, Strehimoren, psikologjen dhe prokurorinë. Kjo është identifikuar në veçanti përmes takimeve të GND-së. Megjithatë, qasja e zyrtarëve përgjegjës nuk ka qenë në përputhje me procedurat dhe me standardet që kërkohen të zbatohen në rastet kur viktimë është fëmijë.
74. Në bazë të informatave dhe të dokumentacionit të çështjes, del se e fëmija ishte viktimë potenciale e trafikimit.
75. Sipas të dhënave nga shkresat e lëndës, del se autoritetet shtetërore, edhe pse ishin të njoftuara për rrezikun e lartë që i kanosej fëmijës, ishte vendosur që fëmija të kthehej në shtëpi. Kjo në kundërshtim me praktikën e lartcekur të GjEDNj-së, lidhur me nenin 3 të KEDNj-së. Është me rëndësi të theksohet se Policia kishte njoftuar se rreziku i saj vazhdonte të ishte i njëjtë, pra vlerësimi i rrezikut ishte i lartë dhe nuk mund të ulej duke pasur parasysh rrethanat e rastit. Kjo vërtetohet se autoritetet e përfshira në rast: prokuroria, policia, Strehimorja dhe QPS-ja, ishin në dijeni për ekzistimin e një rreziku real dhe të menjëhershëm të keqtrajtimit të fëmijës, i identifikuar si viktimë, nga veprimet kriminale të një pale të tretë.
76. Më tutje është e rëndësishme të shqyrtohet përmbushja e kriterit të dytë për lindjen e detyrimit pozitiv nën nenin 3 të KEDNj-së, që, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, nëse autoritetet morën të gjitha masat e arsyeshme për ta mbrojtur fëmijën menjëherë sapo ishin në dijeni për rreziqet me të cilat përballëj ajo.
77. Sipas shkresave të lëndës, përfaqësuesit e Strehimores, të QPS-së, të Policisë dhe psikologjia, me pëlqimin e prokurorit ishte vendosur që fëmija të kthehej në shtëpi pas kërkesave të vazhdueshme të saj dhe të prindërve. Gjatë këtij procesi vërehet se prioritet u

<sup>61</sup> EULEX, Vlerësimi i trajtimit të rasteve të dhunimit nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, Raport i monitorimit, 2022, në [https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/\(07.06.2022\)Report\\_AL.pdf](https://www.eulex-kosovo.eu/eul/repository/docs/(07.06.2022)Report_AL.pdf)

<sup>62</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës, Strategjia kombëtare kundër trafikimit me njerëz në Kosovë 2022-2026, 2022, në: <https://mpb.rks-gov.net/Uploads/Documents/Pdf/AL/2472/Strategjia%20TQNJ%202022-2026.pdf>

<sup>63</sup> LMF, neni 24.



ishte dhënë dëshirave dhe vullnetit të prindërve dhe të fëmijës 11 vjeç, pavarësisht vlerësimit të rrezikut, i cili vazhdonte të ishte i lartë.

78. Neni 12 i KDF-së dhe neni 7 i LMF-së obligon shtetin t'i sigurojnë fëmijës, që është në gjendje t'i formojë pikëpamjet e veta, të drejtën për t'i shprehur ato pikëpamje lirisht në të gjitha çështjet që prekin atë, mirëpo rëndësia e duhur u kushtohet këtyre pikëpamjeve me **moshën dhe me pjekurinë** e fëmijës. Për këtë qëllim, fëmijës duhet t'i jepet veçanërisht mundësia për t'u dëgjuar në çdo proces gjyqësor dhe administrativ që prek fëmijën, qoftë drejtpërdrejt, ose nëpërmjet një përfaqësuesi apo të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat procedurale të vendit. Mirëpo ky obligim limitohet varësisht nga mosha dhe pjekuria e fëmijës dhe përmbushet me dëgjimin e mendimit të fëmijës dhe nuk obligon institucionet të veprojnë domosdo në bazë të tij, por t'ia kushtojnë rëndësinë e duhur. Pikëpamjet e fëmijës duhet të vlerësohen varësisht prej rastit.<sup>64</sup>
79. Marrë parasysh përgjegjësitë institucionale në mbrojtjen e fëmijës nga dhuna dhe nga trafikimi, përvojat dhe kualifikimet e tyre profesionale në këtë fushë, situatën në terren të klasifikuar si të rrezikshme nga policia, si një organ i specializuar në fushën e sigurisë, dhe ndjeshmërinë e rastit, Avokati i Popullit konsideron se institucionet e përfshira do të duhej të ishin në gjendje ta perceptonin dhe ta parashikonin më mirë rrezikun që i kanosej fëmijës, sesa prindërit e fëmijës, të cilët konsideroheshin si laik në fushën e ligjit dhe të sigurisë publike.
80. Avokati i Popullit vëren se, ndonëse ekzistonte mundësia që fëmija të vazhdonte të mbetej në Strehimore, autoritetet kishin vendosur që fëmija të kthehej në shtëpi me datën 21 korrik, pa ndërmarrjen e masave të tjera shtesë mbrojtëse. Gjatë kësaj kohe, mbikëqyrja e vetme institucionale ndaj saj ishte ushtruar përmes komunikimit mes QPS-së dhe prindërve. Rreth një muaj më vonë, më 28 gusht 2022, fëmija ishte paraqitur përsëri në Policinë e Kosovës (PK), ku ishte iniciuar rasti për veprën penale të dhunimit, me ç' rast fëmija, pas procedurave policore, me referim të QPS-së ishte dërguar përsëri në Strehimore.
81. Avokati i Popullit vlerëson se autoritetet nuk e kishin vlerësuar drejt interesin më të mirë të fëmijës dhe as rrethanat e rastit, duke ua falur besimin prindërve, ndonëse vlerësimi i rrezikut ishte ende i lartë. Shto këtu faktin se në shumë shkresa në dokumentacionin e çështjes përmenden elementet dhe rrethanat për rrezikun potencial të fëmijës, përfshirë edhe deklaratat e saj. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ (QRK)-nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative (në tekstin e mëtejshëm: Udhëzimi nr.02/2021)<sup>65</sup> garanton se fëmija, gjatë procedurës ose proceseve të tjera të ndërlidhura, duhet të mbrohet nga dëmtimi, përfshirë frikësimin, hakmarrjen dhe **viktimizimin sekondar**. Në rastin konkret, kur rrethanat tregonin se fëmija mund të ishte objekt kanosjeje, kërcënimi ose dëmtimi, duhej të krijoheshin kushtet e përshtatshme për ta garantuar sigurinë e fëmijës përmes marrjes së masave të nevojshme, t'i ofrohej fëmijës viktimitë dhe dëshmitar mbrojtje nga policia ose nga Organi i Kujdestarisë, në partneritet me subjektet e tjera publike dhe private që ofrojnë mbrojtje

<sup>64</sup> Komiteti i KDF-së, Komenti i Përgjithshëm Nr. 12 (2009) E drejta e fëmijës për t'u dëgjuar, 2009, në: <https://www.refworld.org/docid/4ae562c52.html>

<sup>65</sup> Udhëzimi Administrativ (QRK)-Nr. 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative, është miratuar në mbledhjen e 58-të të Qeverisë së Kosovës, me Vendimin Nr. 04/58, datë 14.01.2021



dhe strehim dhe të mos bëhej publike vendndodhja e tyre.<sup>66</sup> LMF-ja përcakton se të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo nga kujdestari, nga institucionet, nga shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, nga profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, nga gjykatat, nga autoritetet administrative apo nga organet legislative, interesi më i mirë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese dhe më e larta. Interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për të siguruar integritetin fizik, psikologjik, moral dhe shpirtëror të fëmijës dhe për ta promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe gjendjen sociale të fëmijës.<sup>67</sup> Tutje, sipas këtij ligji, për ta siguruar interesin më të mirë të fëmijës duhet të respektohen parimet si në vijim: “*Historia e fëmijës, duke mbajtur parasysh situatat e veçanta të abuzimit, neglizhimit, shfrytëzimit ose forma të tjera të dhunës ndaj fëmijës, si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen.*”<sup>68</sup>

82. Duke u bazuar në argumentet e lartpërmendura, Avokati i Popullit konstaton se autoritetet nuk i kishin përmbushur detyrimet pozitive të cilat i kishin për mbrojtjen e fëmijës nga keqtrajtimi dhe nga trajtimi jonjerëzor, sipas nenit 3 të KEDNj-së, neneve 19 dhe 34 të KDF-së, nenin 56 të Konventës së Stambollit dhe neneve 5, 11.2, 15 (1.2) dhe 24 të LMF-së, meqë ata ishin në dijeni për rrezikun që i kanosej fëmijës dhe kishin dështuar t’i ndërmerrenin të gjitha masat e arsyeshme për ta mbrojtur atë.

#### **B. Përmbushja e obligimeve për ndërmarrjen sa më të shpejtë të veprimeve në mbrojtjen e fëmijës nga dhuna**

83. Siç është theksuar edhe më lart në rastin *V. C. kundër Italisë*, GjEDNj-ja ka theksuar se makineria e mbrojtjes së individit nga keqtrajtimi, e parashikuar në ligjin e brendshëm, duhet të funksionojë në praktikë brenda një kohe të arsyeshme për të përfunduar shqyrtimin mbi themelin e çështjeve specifike të paraqitura tek autoritetet. Këto obligime specifikohen më tutje edhe në LMF. Në mënyrë që procesi të jetë efektiv, LMF-ja kërkon që veprimet, pasi të vendosen përmes një procesi pjesëmarrës, ku dëgjohet edhe mendimi i fëmijës dhe i familjes, nuk duhet t’i nënshtrohen vonesës së padrejtë.<sup>69</sup> Në veçanti, mbrojtja dhe zhvillimi i mëturshëm i fëmijës, që merr parasysh interesin më të mirë të tij, duhet ta formojë qëllimin kryesor të marrjes së vendimeve.<sup>70</sup> **Në të gjitha procedurat, ku janë të përfshirë fëmijët viktime të dhunës, duhet të aplikohet parimi i kryerjes sa më të shpejtë të veprimeve, duke respektuar sundimin e ligjit.**<sup>71</sup> Për më tepër, Udhëzimi Administrativ nr. 02/2021 ka përcaktuar se hetimeve, **procedurave** dhe ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, që përfshijnë fëmijët viktime, duhet t’u jepet prioritet dhe të kryhen pa vonesa të pajustificuara.<sup>72</sup>

84. Sipas Ligjit nr. 05/1-060 për Mjekësinë Ligjore<sup>73</sup>, përkatësisht në nenin 7, afatet për kryerjen e ekzaminimeve mjekoligjore dhe përfundimin e raportit mjekoligjor janë: “*1. Ekzaminimet mjeko ligjore, duhet të kryhen brenda afateve të arsveshme kohore, si në vijim: 1.1. autopsia mjeko ligjore, nuk mund të fillohet me herët se gjashtë (6) orë nga*

<sup>66</sup> Udhëzimi nr. 02/2021, neni 20.

<sup>67</sup> LMF, neni 5, paragrafi 3.

<sup>68</sup> LMF, neni 5, paragrafi 4, nënparagrafi 4.6.

<sup>69</sup> Po aty, par. 5.3.

<sup>70</sup> Po aty, par. 5.4.

<sup>71</sup> Komiteti i KDF-së, Komenti i Përgjithshëm Nr. 13 (2011) par. 54(d).

<sup>72</sup> Udhëzimi nr.02/2021, neni 9.

<sup>73</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /nr. 11/06 prill 2016, Prishtinë.



momenti i konstatimit të vdekjes; 1.2. analizat toksikologjike apo analizat tjera duhet të përfundohen brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve apo më së largu gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e pranimit të kërkesës për këto analiza; 1.3. në rastet të veçanta kufizimi i afatit të përcaktuar në nënparagrafin 1.2 të këtij neni mund të zgjatet pas miratimit me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit. 2. Raporti mjeko ligjor për gjetjet nga paragrafi 1 i këtij neni, në pajtim me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, duhet të përfundohet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të rezultateve të analizave.”

85. Ndërsa neni 19 i Ligjit nr. 04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikë obligon AKF-në: “Të kryej me kohë ekspertizën e dëshmisë dhe krahas dëshmisë, dosjes t’ia bashkëngjit raportin gjithëpërfshirës, në të cilin duhet të jepet mendimi profesional lidhur me ekspertizën e kryer.”
86. Në rastin konkret, AKF-së i janë dashur rreth 68 ditë që ta bënte ekzaminimin dhe tërheqjen e fotove-dëshmime të telefonit të viktimës. Tutje AKF-së i janë dashur rreth 137 ditë që ta bënte ekzaminimin e ADN-së. Ndërsa IML-së i janë dashur rreth 90 ditë që ta dërgonte te prokurori raportin në formë fizike të ekzaminimit.
87. Në bazë të informatave të siguruara dhe të dokumentacionit të çështjes, vërehet se Policia kishte ndërmarrë një varg veprimesh hetimore në pajtim me Ligjin për Policinë<sup>74</sup>, por në rastin konkret vonesat në ekzaminimin e telefonit të viktimës nga AKF-ja kishin ndikuar shumë në punën e organeve të hetuesisë për të ardhur më shpejt deri te identifikimi i të dyshuarve për abuzimin seksual të fëmijës si dhe për sigurimin e dëshmime relevante të nxjerra nga telefoni i viktimës. Policia kishte qenë në dijeni për disa emra të personave si të dyshuar për kryerjen e veprës penale në fjalë, por nuk kishte ndërmarrë veprimet e duhura në pajtim me nenin 120 të KPP-së. Pra organet e hetuesisë kishin dështuar në ushtrimin efektiv të mandatit të plotë të tyre, për faktin se te personat e dyshuar (emrat e përmendur nga fëmija) për abuzim seksual të fëmijës, për pos intervistimit të disa prej tyre dhe veprimeve të tjera, përkatësisht verifikimit të tyre, nuk e kishin përdorur edhe metodën e identifikimit të tyre në bazë të fotografisë, sipas nenit 120 të KPP-së.<sup>75</sup>
88. Avokati i Popullit konstaton se AKF-ja, IML-ja dhe për pasojë Policia, kishin dështuar në ushtrimin efektiv të mandatit të plotë të tyre për ndërmarrjen sa më të shpejtë të

<sup>74</sup> Ligji për Policinë, përkatësisht neni 10, përcakton se PK-ja ka për detyrë: “Të mbrojë jetën, pronën dhe të ofrojë siguri për të gjithë personat, parandaloj dhe t’i zbuloj veprat penale dhe kryesit e tyre, hetoj veprat penale dhe kryesit e tyre si dhe të kryej detyra të tjera të parapara me ligjin në fuqi.”<sup>74</sup> Ndërsa sipas nenit 16, zyrtari policor ka autorizim ta identifikojë personin tjetër atëherë kur: “1.1. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi ka kryer, është duke kryer, ose do të kryejë veprën penale; 1.2. ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi paraqet rrezik për personat ose pronën, ose është duke shkaktuar shqetësim; (...)”

<sup>75</sup>KPP, neni 120, (Identifikimi i personave apo sendeve): “1. Kur është e nevojshme të vendoset se një dëshmitar a e nje personin ose sendin, nga dëshmitari i tillë së pari kërkohet të përshkruajë dhe tregojë tiparet dalluese të personit ose të sendit të tillë. 2. Dëshmitarit pastaj i tregohet personi me persona të tjerë të panjohur për dëshmitarin ose fotografitë e tyre apo sendi me sende të tjera të llojit të njëjtë ose fotografitë e tyre. 3. Dëshmitarit i bëhet me dije se nuk detyrohet të zgjedhë personin ose sendin apo ndonjë fotografi dhe se është po aq e rëndësishme për të treguar se nuk e nje personin, sendin ose fotografinë ashtu sikurse të thoshte se e nje. 4. Procesverbali mbahet për përshkrimin e marrë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përshirë kohën dhe datën e këtij përshkrimi dhe personat e pranishëm me rastin e këtij përshkrimi. Procesverbali mbahet edhe për përshkrimin sipas paragrafit 2. të këtij neni, përshirë kohën dhe datën e identifikimit dhe fotografitë e personave apo sendeve tjera. 5. Identifikimi i peronit apo sendit nga ky nen mund të mbikëqyret nga policia apo nga prokurori i shtetit. Procesverbali nga paragrafi 3. të këtij neni futet në shkresat e lëndës.”



veprimeve në mbrojtjen e fëmijës nga dhuna, siç kërkohet nga LMF-ja dhe nga Udhëzimi nr.02/2021.

### C. Përmbushja e obligimeve të veçanta për mbrojtjen e fëmijës në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe me ligje të tjera

89. Kodi i Drejtësisë për të Mitur (KDM) përmban një kapitull të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë, si dhe qartëson se çka nënkupton shprehja fëmijë e çka nënkupton shprehja i mitur.<sup>76</sup> Përkufizimi sipas këtij kodi: “*I mitur-personi i cili i ka mbushur katërmbëdhjetë (14) vjet por nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet.*” - është tejet i rëndësishëm të përdoret dhe zbatohet drejt nga zbatuesit e ligjit, por jo vetëm. Në rrjedhën e kësaj, Kodi Penal, në neni 225 (Përkufizimet lidhur me veprat penale kundër integritetit seksual), paragrafi 1, përcakton: “*1. Shprehja “pëlqim” nënkupton: 1.1. pajtim i vullnetshëm i personit i cili ka arritur moshën gjashtëmbëdhjetë (16) vjet për të kryer aktin seksual. 1.2. marrëveshja vullnetare e dy personave të cilët kanë arritur moshën katërmbëdhjetë (14) vjet dhe ku dallimi në moshën e tyre nuk tejkalon dy (2) vjet, për të kryer aktin seksual në fjalë.*” Ndërsa neni 227 (Dhunimi), paragrafi 1, përcakton: “*Kushdo që detyron personin tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e personit të tillë, dënohet me burgim prej dy (2) deri në dhjetë (10) vjet.*”
90. Avokati i Popullit vëren se autoritetet shtetërore, që kishin qenë të përfshira në rast, por edhe disa media, fëmijën 11 vjeç e përmendnin si të mitur, gjë që kjo në frymën e zbatimit të këtij kodi dhe të rrethanave të tjera jo vetëm që është shtrembërim i fakteve, por mund të konsiderohet edhe si riviktimizim i fëmijës, shtu këtu faktin pa konstatuar moshën e të dyshuarve për veprën në fjalë, mes të tjerash e ngre nivelin e përgjegjësisë si të viktimës po ashtu edhe të personit/ave si kryerës të veprave penale. Për më tepër, në bazë të dokumentacionit të çështjes, fëmija, gjatë dëgjimit si dëshmitarë, më 7 korrik 2022 ishte trajtuar si e mitur.
91. Sipas KDM-së, interesi më i mirë duhet të jetë konsiderata mbizotëruese gjatë gjithë procedurës dhe veprimeve që ndërmerren ndaj fëmijës dhe të miturit.<sup>77</sup> Fëmijës duhet t’i sigurohet asistencë e plotë ligjore gjatë hetimit penal. KDM-ja, në nenin 112, paragrafi 6, ka përcaktuar se fëmija si viktimë e veprës penale duhet të ketë përfaqësues të autorizuar në të gjitha fazat e procedurës penale. Për qëllim të këtij kapitulli, përfaqësues i autorizuar nënkupton përfaqësuesin, siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 63 të KPP-së.<sup>78</sup> Gjithashtu neni 120 i këtij kodi (Mbrojtja ligjore) ka përcaktuar: “*1. Mbrojtja ligjore për fëmijët viktimë bëhet përshtatshëmrisht sipas nenit 63 paragrafi 1. dhe 2. i Kodit të procedurës penale. 2. Në rastet kur viktimë ose përfaqësuesi i tij ligjor nuk angazhon përfaqësues të autorizuar, gjykata ose prokurori i shtetit ose ndonjë autoritet tjetër që drejton procedurën e emëron një përfaqësues të autorizuar sipas detyrës zyrtare me shpenzime publike.*” Në sistemin e drejtësisë duhet të ndiqen procedurat gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në interesin më të mirë dhe në respektimin e plotë të të drejtave të

<sup>76</sup> KDM, neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2: “*I mitur-personi i cili i ka mbushur katërmbëdhjetë (14) vjet por nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet*”

<sup>77</sup> KDM, neni 4, paragrafi 1. Këtë parim themelor ky kod e thekson edhe në Pjesën e Pestë, Kapitulli II, neni 110 (Mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitar): “*Çdo fëmijë viktimë apo dëshmitar, në kontekstin e këtij kapitulli, ka të drejtë që interesi i tij më i mirë të jetë konsiderata mbizotëruese.*”

<sup>78</sup> KPP, neni 63: “*1. Dëmtuari mund të përfaqësohet nga përfaqësuesi i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës; 2. I dëmtuari mund të përfaqësohet nga mbrojtësi i viktimave; 3. I dëmtuari mund të përfaqësojë veten.*”



fëmijës, duke përfshirë të drejtën për t'u mbrojtur nga të gjitha format e dhunës.<sup>79</sup> Për t'i mbrojtur të drejtat e fëmijës dhe interesat e ligjshme të fëmijëve gjatë gjithë procesit, atyre duhet t'u jepet qasje në ndërmjetësim, në shërbime ligjore të lira dhe të pavarura dhe në shërbime avokatie dhe mbështetëse. Për më tepër, LMF-ja ka përcaktuar se fëmijës që është viktimizuar nga shkelja e legjislacionit në fuqi, i sigurohet ndihma juridike pa pagesë për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tij.<sup>80</sup> Pra, autoritetet përgjegjëse nuk ia kishin siguruar mbrojtjen e duhur ligjore fëmijës, në pajtim me KDM-në dhe LMF-në.

92. Sipas dokumentacionit të çështjes, më 7 korrik 2022<sup>81</sup> fëmija ishte marrë në pyetje si dëshmitar. Për më tepër, në këtë dokument thuhej se të **pandehurit** i ishte lexuar paralajmërimi me dispozitën e nenit 25, paragrafi 1: “Ky është një hetim penal. Ju jeni i detyruar të dëshmoni. Ju jeni i detyruar të tregoni të vërtetën. Nëse ju nuk tregoni të vërtetën, mund të ndiqeni sipas nenit 390 ose 391 të Kodit Penal. Nëse besoni se ju mund të fajësoni veten si rezultat i përgjigjeve në pyetje, ju mund të refuzoni të përgjigjeni. Nëse besoni se keni nevojë për ndihmën e avokatit si rezultat i përgjigjes në një pyetje, ju mund të angazhoni dhe të këshilloheni me një avokat. Ky hetim penal kërkon të gjejë të vërtetën dhe kujtesën sa më të saktë të fakteve që ju mund të ofroni. Nëse ju nuk e kuptoni pyetjen që u është bërë, ju duhet të kërkonit që pyetja të ju bëhet ndryshe. Nëse besoni se ka një dokument ose prova të tjera që mund t'iu ndihmojnë për tu përgjigjur në pyetje sa më saktë apo t'iu kujtohen faktet më qartë, ju jeni të detyruar të na tregoni. Nëse keni nevojë për ndihmë, përkthim, apo pushim të shkurtër dhe të arsyeshëm nga kjo seancë, ju duhet të kërkonit atë. A i kuptoni këto të drejta?” Në rrjedhën e kësaj, nenet 390 dhe 391 në këtë dispozitë i referohen Kodit Penal<sup>82</sup>:

#### “Neni 390

##### *Lajmërimi apo kallëzimi i rremë*

1. Kushdo që bën lajmërim të rremë të personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se personi i caktuar ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, duke e ditur se personi i tillë nuk është kryesi, dënohet me gjobë ose me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet.

2. Kushdo që ofron prova të rreme për veprën penale ose në ndonjë mënyrë tjetër shkakton fillimin e procedurës penale për veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare kundër personit për të cilin ai e di se nuk e ka kryer veprën penale, dënohet me dënimin nga paragrafi 1. i këtij neni.

3. Kushdo që lajmëron veten se ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse nuk e ka kryer veprën e tillë, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) muaj. 4. Kushdo që lajmëron se personi zyrtar i ngarkuar me detyrën për të hetuar apo ndjekur, se është kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, edhe pse ai e di se vepra nuk është kryer, dënohet me dënimin nga paragrafi 3. i këtij neni.

#### Neni 391

##### *Deklarimi i rremë nën betim*

<sup>79</sup>Në vitin 2009, Grupi i Specialistëve për Drejtësinë Miqësore ndaj Fëmijës (CJ-S-CH) hartoi udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësinë miqësore ndaj fëmijës.

<sup>80</sup>LMF, neni 56, paragrafi 1.

<sup>81</sup>Procesverbal mbi dëgjimin e dëshmitarit të dëmtuar, RN.20/2022.

<sup>82</sup>Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.19/13 Korrik 2012, Prishtinë.



1. Kushdo që pasi të ketë dhënë betimin pranë organit kompetent për të administruar dëshmitë e dhëna nën betim ose betimet dhe pastaj nënshkruan dëshminë nën betim ose deklaron diç që nuk beson se është e vërtetë ose me dijeni fsheh ose shmang nga deklarimi ndonjë çështje relevante për procedurën, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet. 2. Nëse deklarata nga paragrafi 1. i këtij neni është dhënë gjatë procedurës penale, kryesi dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë (5) vjet. 3. Nëse kryesi i veprës penale nga paragrafi 1. i këtij neni vullnetarisht e tërheq deklaratën e tij para fundit të dëshmisë së tij, gjykata mund ta zbusë dënimin.”

93. Avokati i Popullit vëren se fëmija, kur është dëgjuar si dëshmitar i dëmtuar, nuk ka qenë i mitur, andaj nuk mund të paralajmërohet se mund të ndiqet penalisht, kur dihet fakti se personat nën moshën 14 vjeç janë penalisht të papërgjegjshëm. Rrjedhimisht, fëmija në fjalë, si viktimë apo si dëshmitar, ka të drejtë t'i shprehë pikëpamjet, opinionet dhe bindjet e veta lirisht, me fjalët e tij, dhe ka të drejtë të japë kontribut për vendimet që ndikojnë në jetën e vet, përfshirë vendimet që merren gjatë procesit gjyqësor, të garantuara me nenin 7 të LMF-së.<sup>83</sup> Prandaj në këtë rast autoritetet përgjegjëse kishin dështuar ta zbatonin drejt Pjesën e Pestë, Kapitulli II (Mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitarë) të KDM-së dhe nenin 7 të LMF-së.
94. Sipas KDM-së, në rastet kur zbatohet procedurë për veprë penale të kryer ndaj fëmijës, institucionet veprojnë me kujdes të posaçëm ndaj fëmijës i cili ka pësuar dëmtime nga vepra penale, duke e pasur parasysh moshën e tij, karakteristikat personale, nevojat e veçanta, edukimin dhe ambientin në të cilin jeton ai, në mënyrë që t'u shmangen pasojave të mundshme të dëmshme për edukimin dhe zhvillimin e tij. Në frymën e kësaj edhe KDF-ja përcakton se shteti duhet të ndërmarrë të gjitha masat e duhura për të nxitur shërimin fizik **dhe psikologjik** dhe rehabilitimin e fëmijëve viktimë dhe dëshmitarë të dhunës<sup>84</sup> dhe të familjeve të tyre, nëse është e nevojshme. Shërbime të tilla duhet të sigurohen pa vonesë dhe në një mjedis i cili nxit shëndetin e fëmijës, vetërespektin dhe dinjitetin. Obligime të tilla parashihen edhe me Konventën e Stambollit. Për më tepër, LMF-ja ka përcaktuar se fëmija viktimë e abuzimit nuk duhet të lihet pa ndihmë psikologjike ose pa forma të tjera asistencë.<sup>85</sup> Sipas dokumentacionit të çështjes, Avokati i Popullit vëren se fëmija, më 22 qershor 2022, ishte dërguar në Strehimore dhe seanca e parë psikoterapike ndaj tij kishte filluar më 28 qershor 2022, krejt kjo në mungesë të psikologut në këtë qendër. Avokati i Popullit rithekson faktin se dhuna ndaj fëmijëve është jashtëzakonisht komplekse dhe me pasoja të rënda psiko-sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës. Hulumtimet tregojnë se nëse fëmija ka përjetuar cilëndo formë të abuzimit dhe nëse nuk e ka marrë ndihmën e nevojshme, do të

<sup>83</sup> Neni 7 i LMF-së thotë: “1. Në të gjitha veprimet dhe vendimet, që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga prindërit apo kujdestari, institucionet, shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, profesionistët për mbrojtjen e fëmijës, gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislativë, kanë për obligim t'i garantojnë fëmijës, i cili është i aftë të ketë pikëpamjet e tij, të drejtën për t'i shprehur lirisht këto pikëpamje, për çdo çështje që ka të bëjë me të, duke i vlerësuar ato në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së tij, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjisllacionit në fuqi. 2. Në të gjitha veprimet e ndërmarra në zbatim të këtij Ligji dhe legjisllacionit në fuqi, posaçërisht në çështjet administrative dhe procedura gjyqësore, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës, duhet të merren në konsideratë në përputhje me moshën dhe shkallën e pjekurisë së fëmijës.(...)”.

<sup>84</sup>KDF, neni 39.

<sup>85</sup> LMF, neni 57, paragrafi 5.



ketë pasojë negative më vonë si i rritur dhe do të jetë e vështirë të tejkalohen pa trajtim adekuat.<sup>86</sup> Andaj, në rastin konkret, ofrimi i shërbimeve psikologjike ka qenë i vonuar.

95. Tutje, KDM-ja ka përcaktuar se Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave ka **për obligim të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të viktimave në sistemin e drejtësisë**. Ky obligim ekziston kryesisht gjatë procedurës së hetimeve, të ndjekjes dhe të dënimit të një kryerësi.<sup>87</sup> Po ashtu, Mbrojtësi i Viktimave ka kompetencë **për ta njoftuar palën e dëmtuar për të drejtat e saj** dhe përfaqësimin e interesave të viktimës në procedurën në prokurori dhe në gjykatë dhe, kur është e nevojshme, e referon viktimën tek ofruesit e tjerë të shërbimeve.<sup>88</sup> Sipas LPLTNJMVTR-së, në rastet kur një vepër penale përmban ndonjë nga elementet e veprës së trafikimit me njerëz, nga neni 5 i këtij ligji, vepra e tillë do të konsiderohet si vepër që ndërlidhet me trafikim me njerëz.<sup>89</sup> Rrjedhimisht viktimat e veprave penale nga ky nen mund të konsiderohen viktimat të trafikimit dhe si të tilla i gëzojnë të gjitha të drejtat e parapara me ligj.<sup>90</sup> Për më tepër, LMF-ja ka përcaktuar se në të gjitha veprimet dhe vendimet që kanë të bëjnë me marrjen e pikëpamjes së fëmijës kjo kërkon pos të tjerash që fëmija të marrë ndihmë juridike falas në pajtim me legjislacionin në fuqi.<sup>91</sup> Sipas dokumentacionit të çështjes në ZMNV, thuhet: *“Intervistimi i të miturës 11 vjeçare ka ndodhur më datë 07.07.2022 nga Prokurori i rastit, ku prezent kanë qenë edhe përfaqësuesit e institucioneve gjegjëse; Mbrojtësi i Viktimave, Punëtori Social, Psikologja. Intervistimi ka qenë korrekt.”* Tutje në dokumentacionin e çështjes thuhet se në ditën kur ishte takuar GND-ja dhe ishte liruar fëmija nga Strehimorja, kishte munguar Mbrojtësi i Viktimave për arsye, sipas tyre: *“Mbrojtësi i Viktimës nuk ka qenë prezent për shkak të agjendës së tij të ngjeshur (me seance dhe raste pune).”* Ky arsyetim nga ana e mbrojtësit të viktimës nuk ishte i qëndrueshëm duke marrë parasysh seriozitetin dhe ndjeshmërinë e rastit si dhe moshën e fëmijës vajzë, e cila e vë atë në rrezik më të ndjeshëm ndaj dhunës në baza gjinore. Legjislacioni kërkon që rastet e fëmijëve të trajtohen me prioritet dhe me seriozitet. Për më tepër, sipas dokumentacionit të çështjes në ZMNV, nuk vërehet se fëmija ishte njoftuar për të drejtat e saj, si viktimë dhe palë e dëmtuar. Andaj ZMNV-ja kishte dështuar t’i zbatonte plotësisht nenet 117 dhe 118 të KDM-së.

96. LPLTNJMVTR-ja, në nenin 5 (elementet e veprës penale të trafikimit me njerëz) përcakton: *“1. Siç është përcaktuar në nenin 171 të Kodit Penal, elementet e trafikimit me*

<sup>86</sup> Opinioni i Avokatit të Popullit në lidhje me ndikimin e dhunës në shëndetin dhe në jetën sociale të fëmijëve, si dhe masat që duhen ndërmarrë institucionet përgjegjëse (më 15 nëntor 2016).

<sup>87</sup> KDM, neni 117.

<sup>88</sup> Po aty, neni 118.

<sup>89</sup> LPLTNJMVTR, nenin 10.

<sup>90</sup> Procedurat Standarde të Veprimit për Personat e Trafikuar (PSVPT) thotë: *“Një person i supozuar si i trafikuar gëzon të njëjtat të drejta dhe trajtim, si edhe viktimat identifikuar që nga fillimi i procesit identifikues.”* Po ashtu sipas PSVPT-së, viktimat e trafikimit duhet të informohen për të drejtat: *“Të drejtën për tu trajtuar në mënyrë të barabartë me palën tjetër. Të drejtën për të kërkuar mbrojtje psiko-fizike. Të drejtën që të përdorni gjuhën që e flisni dhe e kuptoni. Të drejtën që rasti juaj të trajtohet me konfidencialitet. Të drejtën për ndihmë dhe trajtim mjekësor. Të drejtën për strehim të sigurt. Të drejtën për ushqim dhe veshmbathje. Të drejtën që të ndihen komod. Të drejtën për të kontaktuar me të afërmit apo të përzgjedhurit tuaj. Të drejtën që të parashtroni pyetje dhe propozoni dëshmitë. Të drejtën për arsim formal dhe jo formal. Të drejtën për kompensim. Të drejtën për qëndrim në territorin e Kosovës. Të drejtën për pezullimin e dëbimit. Të drejtën për kthim në vendin e origjinës ose vendosjen në vendin e tretë. Të drejtën për tu trajtuar si dëshmitar i mbrojtur. Të drejtën për angazhim pa pagesë e përfaqësuesit të autorizuar. Të drejtën për mos ndëshkim për veprat që keni kryer si pasojë e të qenit e trafikuar. Të drejtën për të mos u ballafaquar me kryesin e veprës penale.”*

<sup>91</sup> LMF, neni 7, paragrafi 3, nënparagrafi 3.5.



njerëz përbëhen nga: 1.1. rekrutimi, 1.2. transportimi, 1.3. transferimi, 1.4. strehimi apo pranimi i personave, me anë të kanosjes dhe përdorimit të forcës apo formave tjera të shtrëngimit, 1.5. rrëmbimit, 1.6. mashtrimit, 1.7. lajthimit, 1.8. keqpërdorimit të pushtetit apo keqpërdorimit të pozitës së ndjeshme dhe 1.9. dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër, për qëllim të shfrytëzimit.” Tutje paragrafi 3 i këtij neni thotë: “Kur sjellja e cekur në paragrafin 1 të këtij neni përfshinë **fëmijë**, atëherë ajo është veprë e dënueshme e trafikimit me njerëz edhe nëse nuk është përdorur asnjëri nga mjetet e parapara në paragrafin 1 të këtij neni, siç përcaktohet me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.” Pra identifikimi i një personi si viktimë e trafikimit apo viktimë e mundshme e trafikimit kërkon prezencën e së paku një nga treguesit e përcaktuar në Udhëzimin Administrativ QRK-NR-10/2017 për listën e tregueseve për identifikimin zyrtar të viktimave të trafikimit, përkatësisht nenin 4: “1.1. Veprimi: Rekrutimin, transportimin, transferimin, strehimin apo pranimin e personave; 1.2. Mjetet: Kanosje, përdorimi i forcës, format tjera të shtrëngimit, rrëmbimi, mashtrimi, lajthimi, keqpërdorimi i pushtetit apo i pozitës së ndjeshme, dhënia apo marrja e pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit që ka kontroll mbi personin tjetër; 1.3. Qëllimi i shfrytëzimit: Shfrytëzimi përfshin por nuk kufizohet në shfrytëzimin për prostitucion, pornografi ose forma tjera të shfrytëzimit seksual, lëmshës, punë ose shërbime të detyruar, skllavëri dhe veprime të ngjashme të skllavërisë, robëri ose heqjen e organeve.” Për identifikimin e një personi si viktimë e trafikimit apo viktimë e mundshme e trafikimit nevojitet prezenca e së paku një nga treguesit e cekur në këtë nen. Nëse viktimja e trafikimit është **fëmijë**, cilado nga veprimet e përdorura, me qëllim të shfrytëzimit, konsiderohet trafikim me njerëz edhe nëse nuk përfshin asnjërin nga mjetet si në paragrafin 1.2 të këtij neni. Në kontekst të kësaj, sipas dokumentacionit të çështjes në Polici, për çështjen e kthimit të fëmijës në familje, Policia kishte theksuar se vlerësimi i rrezikut ishte i lartë dhe nuk mund të ulej duke pasur parasysh rrethanat e rastit.

97. Sipas dispozitave të LPLTNJMVTR-së, fëmijët viktimja pranojnë trajtim të veçantë, që synon parandalimin e viktimizimit të serishëm. Po ashtu, intervista me viktimat fëmijë bëhet pa vonesë të paarsyeshme pas raportimit të fakteve tek autoritetet përkatëse.<sup>92</sup> Në bazë të dokumentacionit të çështjes, fëmija ishte intervistuar 16 ditë pas raportimit të rastit dhe nuk ishte e qartë se cilat ishin arsyet për këtë vonesë.
98. Një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve e luan edhe Organi i Kujdestarisë. Ligji nr. 04/L-081 e përcakton Organin e Kujdestarisë si organ komunal profesional për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e **interesave të fëmijëve** dhe të të rriturve, i përbërë **nga një grup ekspertësh**, që vepron në kuadër të QPS-ve. Ky organ, në rastin konkret, nuk kishte vepruar, kishte dështuar në ndërmarrjen e veprimeve në pajtim me detyrimet ligjore, në vlerësimin gjithëpërfshirës profesional të nevojave të fëmijës dhe në kërkimin e masave mbrojtëse nga gjykata,<sup>93</sup> meqë kishte ekzistuar dyshimi i bazuar se fëmija mund të ketë qenë viktimë e abuzimit seksual, përveç të tjerash. Nga informatat dhe dokumentacioni të siguruara lidhur me rastin, rezulton se Organi i Kujdestarisë nuk është marrë fare me çështjen. Tutje sipas LMF-së, Organi i Kujdestarisë

<sup>92</sup> LPLTNJMVTR, neni 16.

<sup>93</sup> Ligji nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare dhe Ligji nr. 04/L-081 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-17 për Shërbime Sociale dhe Familjare.



nënkupton organin përgjegjës, që vepron në kuadër të QPS-së përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës.<sup>94</sup>

99. Po ashtu, LMF-ja në nenin 27 (Ndarja e fëmijës nga familja), ka përcaktuar: “1. Fëmija nuk do të largohet nga kujdesi i prindit/prindërve të tij ose të kujdestarit të tij ligjor pa lejen e tyre apo pa urdhër të gjykatës. 2. Përjashtimisht, kur organi i kujdestarisë ka arsye të bazuar për të besuar se ekziston rrezik serioz i drejtpërdrejtë për shëndetin, sigurinë apo mirëqenien e fëmijës, organi i kujdestarisë mund të hyjë në cilindo vend dhe të largojë fëmijën në një vend të sigurt, ku ai/ajo do të ketë përkujdesje për një periudhë që nuk kalon shtatëdhjetë e dy (72) orë. 3. Para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, organi i kujdestarisë rastin duhet ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës. Nëse e kërkojnë rrethanat, gjykata mund të jep urdhër për vlerësim për një periudhë njëzet e një (21) ditëshe, për të mundësuar hetime të mëtutjeshme dhe vlerësime deri në kohë kur çështja duhet të paraqitet në gjykatë për shqyrtim të mëtejshëm. 4. Fëmija nuk mund të ndahet nga prindërit, kujdestari i tij kundër dëshirës dhe vullnetit të tij, përveç se në rastet nëse kjo ndarje është në interesin më të mirë të fëmijës, nëse fëmija është në rrezik dhe nëse kjo ndarje është e pashmangshme dhe nëse kjo ndarje kërkohet nga ligji ose nga një vendim i gjykatës i formës së prerë. Nëse fëmija ndahet nga prindërit, kujdestari i tij, pikëpamjet dhe dëshirat e fëmijës duhet të dëgjohen, konsiderohen dhe dokumentohen në dokumentacionin që hartohet për këtë qëllim. Pikëpamjet e fëmijës duhet të dëgjohen dhe dokumentohen nga shërbimet sociale ose gjykata. (...)” Sipas dokumentacionit të çështjes në QPS, vërehet se, pasi fëmija ishte dërguar në Strehimore, më 22 qershor 2022, kishin kaluar 5-8 ditë kur ishte dhënë pëlqimi i prindërve të fëmijës<sup>95</sup> që vajza e tyre të strehohej në Strehimore duke vlerësuar interesin më të lartë të fëmijës, gjersa policia t’i zhvillonte procedurat e nevojshme. Pra, rasti kishte ndodhur më 22 qershor 2022, ndërsa pëlqimi i prindërve për ndarjen e tyre nga fëmija, përkatësisht për dërgimin e fëmijës në Strehimore ishte dhënë më 27 qershor 2022, nr.prot.839, dhe më 30 qershor 2022, nr. prot. 871. Rrjedhimisht, në rastin konkret nuk ishin zbatuar autorizimet ligjore që dalin nga neni 27 i LMF-së.

100. LMF-ja në nenin 30 (Shtëpitë për mbrojtjen e fëmijës) ka përcaktuar: “1. Me këtë ligj themelohen shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve, nga Ministria përkatëse për Punë dhe Mirëqenie Sociale, në bazë të Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale pran Qendrave për Punë Sociale përkatëse ku funksionojnë gjykatat dhe prokuroritë themelore [...] 3. Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijës ofrojnë shërbime emergjente për mbrojtjen e fëmijës, jo më gjatë se tri (3) ditë. 4. Shtëpitë shërbejnë edhe si qendra për zhvillimin e procedurave për të gjitha rastet e dhunës, me theks të veçantë veprave penale kundër integritetit seksual, kur fëmija është viktimë apo dëshmitar. Ofrimin e shërbimeve këshilluese, veçanërisht terapive të ndryshme, si dhe shërben si vend strehim i përkohshëm i fëmijëve të cilët nuk kanë mundësi të kthehen në shtëpi, nuk mund të strehohen në strehim familjar, apo atyre që janë në shtëpi por kërkohet largimi i tyre për shkak të rrezikut të lartë që i kanoset jetës apo shëndetit të tyre [...]” Avokati i Popullit, lidhur me zbatimin e LMF-së, kishte publikuar Raport me rekomandime për Qeverinë e Kosovës, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Komisionin e Pavarur të Mediave, për t’i

<sup>94</sup> LMF, neni 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.45. LMF-ja në nenin 3, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, e përcakton se mbrojtja e fëmijës nënkupton parandalimin dhe përgjigjen ndaj dhunës, keqtrajtimit, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhencës, rrëmbimit, shfrytëzimit seksual, trafikimit dhe punës së fëmijës në dhe jashtë shtëpisë.

<sup>95</sup> QPS- Nr. prot. 871, datë 30.6.2022, dhe Nr.prot.839, datë 27.6.2022.



miratuar aktet nënligjore përkatëse.<sup>96</sup> LMF-ja kishte autorizuar institucionet kompetente që në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e tij, në korrik të vitit 2020, të nxirreshin 18 aktet nënligjore, në mesin e këtyre akteve nënligjore bënte pjesë edhe akti përkatës, i cili rregullon organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës. Deri më publikimin e këtij raporti, Avokati i Popullit vëren se ende nuk është nxjerrë akti nënligjor për **organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës, si parakusht kryesor për zbatimin e nenit 30 të LMF-së.**

101. Avokati i Popullit gjithashtu vëren se moszbatimi i autorizimeve ligjore që dalin nga Ligji nr. 02/L-121 për vendbanimin dhe vendqëndrimin (Ligji nr.02/L-121)<sup>97</sup> ka kontribuar jo vetëm në pengimin e zhvillimit të hetimeve, por edhe në shtimin e kryerjes se veprave të tilla penale. Ligji nr. 02/L-121, përveç të tjerash, rregullon edhe lajmërimin dhe çlajmërimin e mysafirit dhe obligon për mbajtjen e evidencave përkatëse. Objektet turistike dhe hoteliere, duke përfshirë edhe motelet, kanë për obligim mbajtjen e “evidencës së mysafirëve”, e cila mbahet në kompjuterë apo me dorë me të dhënat e qytetarëve që i kanë pranuar për fjetje, për pushim apo për qëndrim të përkohshëm.<sup>98</sup> Qiradhënësi i motelit, gjegjësisht personi i punësuar nga qiradhënësi, ka për obligim që t’i lajmërojë dhe çlajmërojë personat **nën moshën 16 vjet** kur vendosen së bashku me prindër, me kujdestarë apo me anëtarë të ngushtë të familjes, duke mbajtur të dhënat: emrin dhe mbiemrin; numrin personal; datën e lindjes; gjininë dhe shtetësinë.<sup>99</sup> Gjithashtu ky ligj përcakton se qiradhënësi është i obliguar që zyrtarit të organit kompetent apo policisë t’i mundësojë qasje në evidencën e mysafirëve dhe t’ia përcjellë të dhënat nga evidenca, nëse kjo kërkohet, në pajtim me dispozitat ligjore.<sup>100</sup> Sipas nenit 23, mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligj e kryen Ministria për Punë të Brendshme.
102. Më 27 qershor 2022, Prokuroria kishte lëshuar një urdhëresë me të cilën urdhërohej personi përgjegjës i motelit, ku dyshohej se ishte kryer dhunimi, ta lejonte tërheqjen e video-incizimeve të kamerave të vendosura në hyrje të oborrit të këtij moteli, për periudhën e caktuar dhe evidencën e vizitorëve.<sup>101</sup> Në bazë të shkresave del se në evidencat e vizitorëve në motelin në fjalë ishin marrë vetëm të dhënat e tabelave të veturave që kishin frekuentuar aty por jo edhe të vizitorëve, gjë që kishte vështiruar punën e organeve të hetuesisë t’i identifikonte sa më parë kryerësit e dyshuar për veprën penale.
103. Avokati i Popullit vlerëson se mosmbajtja e evidencës, sipas Ligjit nr. 02/L-121, nga personat përgjegjës të objekteve në fjalë, përpos shkeljeve ligjore, në rastin konkret kishte ndikuar negativisht në procesin e zhvillimit të hetimeve nga organet e hetuesisë.

<sup>96</sup> Për më shumë detaje shih, Raport me Rekomandim *Ex-officio* nr. 381/2020 në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, 2021, në: <https://oik-rks.org/raportet/ex-officio-raportet/> [e qasur së fundmi më datën 3.1.2021].

<sup>97</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: Viti III / nr. 40 / 15 tetor 2008.

<sup>98</sup> Lgji nr.02/L-121, neni 2.

<sup>99</sup> Po aty, neni 8.

<sup>100</sup> Ligji nr.02/L-121, neni 12, paragrafi 1 (Mbajtja e evidencës së mysafirëve).

<sup>101</sup> PK: Raport-implementimi i urdhëresës me nr. RNM.nr.20/2020, i datës 4.7.2022.



## Konstatimet e Avokatit të Popullit

104. Avokati i Popullit, pas rishikimit të legjislacionit përkatës vendor dhe ndërkombëtar, të dokumentacionit të çështjes, të informatave dhe të të dhënave të paraqitura nga institucionet përkatëse, konstaton se në rastin konkret *ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të fëmijëve*, përkatësisht shkelje të detyrimeve pozitive të shtetit për mbrojtjen e fëmijës nga keqtrajtimi dhe trajtimi jonjerëzor, sipas nenit 3 - *Ndalimi i torturës*, të KEDNj-së, neneve 19 dhe 34 të KDF-së, nenin 56 të Konventës së Stambollit dhe neneve 5, 11.2, 15 (1.2) dhe 24 të LMF-së, meqë Prokuroria, Qendra për Punë Sociale, Policia dhe Mbrojtësi i Viktimave ishin në dijeni për rrezikun që i kanosej fëmijës dhe kishin dështuar t'i ndërmerrnin të gjitha masat e arsyeshme për ta mbrojtur atë.
105. Avokati i Popullit konsideron se prioritizimi i pikëpamjes dhe i pëlqimit të fëmijës dhe i prindërve mbi raportin e Policisë për nivelin e rrezikut të lartë, si arsye për lëshimin e fëmijës nga Strehimorja, ishte vlerësim i gabuar dhe me pasoja të rënda për fëmijën duke kontribuar drejtpërdrejt në riviktimizimin e tij. Marrë parasysh përgjegjësitë institucionale në mbrojtjen e fëmijës nga dhuna dhe nga trafikimi, përvojat dhe kualifikimet e tyre profesionale në këtë fushë, situatën në terren, e klasifikuar nga policia si e rrezikshme (policia si një organ i specializuar në fushën e sigurisë), moshën e fëmijës dhe pozitën e tij të cënueshme si viktimë e dhunës në bazë gjinore, Avokati i Popullit konsideron se institucionet e përfshira mbajnë përsipër barrë më të lartë të përgjegjësisë dhe do të duhej të ishin në gjendje ta perceptonin dhe ta parashikonin më mirë rrezikun, i cili i kanosej fëmijës, sesa prindërit e fëmijës, të cilët konsideroheshin si laik në fushën e të ligjit dhe të sigurisë publike.
106. Avokati i Popullit vëren se, pavarësisht mundësive ligjore, nuk ishte ndërmarrë ndonjë masë shtesë mbrojtëse për mbrojtjen e fëmijës nga dhuna pas lëshimit nga Strehimorja. Gjatë kësaj kohe, mbikëqyrja e vetme institucionale ndaj fëmijës ishte ushtruar përmes komunikimit mes QPS-së dhe prindërve. Avokati i Popullit rithekson se interesi më i mirë i fëmijës kërkon një përpjekje tërësore për ta siguruar integritetin fizik, psikologjik, morai dhe shpirtëror të fëmijës dhe për ta promovuar dinjitetin njerëzor, duke marrë parasysh karakteristikat individuale dhe rrethanat e tjera të rastit. Në rastin konkret autoritetet përgjegjëse kishin dështuar ta zbatonin nenin 5 të LMF-së, përkatësisht ta siguronin interesin më të mirë të fëmijës, i cili nen obligon kujdes të shtuar në raport me historinë e fëmijës, duke pasur parasysh situatat e veçanta të abuzimit si dhe rrezikun e mundshëm që situata të ngjashme të ndodhin në të ardhmen. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konstaton se autoritetet nuk kishin vepruar në interesin më të mirë të fëmijës.
107. Avokati i Popullit konstaton shkelje të parimit për kryerjen sa më të shpejtë të veprimeve, siç kërkohet sipas nenit 5 të LMF-së dhe sipas Udhëzimit nr.02/2021, gjë që ka penguar ndërmarrjen sa më të shpejtë të veprimeve në mbrojtjen e fëmijës nga dhuna dhe hetimin e veprave penale. AKF-së i ishin dashur rreth 68 ditë që ta bënte ekzaminimin dhe tërheqjen e fotove-dëshmimeve të telefonit të viktimës dhe rreth 137 ditë që ta bënte ekzaminimin e ADN-së. Ndërsa IML-së i ishin dashur rreth 90 ditë që ta dërgonte raportin tek Prokuroria në formë fizike. Në asnjë nga shkresat e lëndës nuk figurojnë përpjekje apo veprime për përsheptimin e veprimeve dhe prioritizimin e tyre sipas legjislacionit në fuqi, duke marrë parasysh moshën e fëmijës dhe rrethanat e rastit.



108. Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit të çështjes, vlerëson se organet e hetuesisë kishin qenë në dijeni për disa persona të dyshuar të përmendur nga fëmija viktimë, por nuk kishin ndërmarrë veprimet e duhura në pajtim me nenin 120 të KPP-së.
109. Avokati i Popullit, në bazë të analizimit të dokumentacionit të çështjes dhe analizimit të dispozitave përkatëse ligjore, vëren se nuk është siguruar mbrojtje e duhur ligjore për fëmijën, sipas KDM-së dhe LMF-së, sepse fëmija ishte trajtuar si i mitur dhe atij nuk i ishin lexuar të drejtat e tij sipas ligjit. Andaj Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit të çështjes, vlerëson se ZMNV-ja kishte dështuar t'i zbatonte plotësisht nenet 117 dhe 118 të KDM-së.
110. Avokati i Popullit vëren se autoritetet shtetërore që kishin qenë të përfshira në rast, por edhe disa media, fëmijën 11 vjeç e përmendnin si të mitur, gjë që në frymën e zbatimit të KDM-së dhe të rrethanave të tjera mund të konsiderohet si riviktimizim i fëmijës. Për më tepër, në bazë të dokumentacionit të çështjes, gjatë dëgjimit si dëshmitar, fëmija ishte trajtuar si i mitur. Avokati i Popullit rithekson se fëmijët nën moshën 14 vjeç janë penalisht të papërgjegjshëm. Rrjedhimisht fëmija në fjalë, si viktimë apo dëshmitar, ka të drejtë t'i shprehë lirisht pikëpamjet, opinionet dhe bindjet e veta, me fjalët e veta, dhe ka të drejtë të japë kontribut për vendimet që ndikojnë në jetën e vet, përfshirë vendimet që merren gjatë procesit gjyqësor. Prandaj Avokati i Popullit konstaton se autoritetet përgjegjëse kishin dështuar në zbatimin e drejtë të Pjesës së Pestë, Kapitulli II (Mbrojtjen e fëmijëve viktimë apo dëshmitar) të KDM-së dhe nenin 7 të LMF-së.
111. Avokati i Popullit vlerëson se organi i kujdestarisë nuk është marrë fare me çështjen, si organ komunal profesional për çështje sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve dhe të të rriturve.
112. Avokati i Popullit konstaton se ofrimi i shërbimeve psikologjike kishte qenë i vonuar, në kontekst të faktit se dhuna ndaj fëmijëve është jashtëzakonisht komplekse dhe me pasoja të rënda psiko-sociale, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen dhe në zhvillimin e fëmijës dhe se qasja e bazuar në të drejta të fëmijëve kërkon reagim të shpejtë dhe efikas.
113. Avokati i Popullit vëren se nuk ka ndonjë vendim nga autoritetet përgjegjëse lidhur me çështjen me rastin e vendosjes së fëmijës në strehimore dhe me lirimin e saj nga strehimorja në pajtim me nenin 27 të LMF-së.
114. Avokati i Popullit vlerëson se moshartimi i aktit përkatës nënligjor, i cili rregullon organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës, si parakusht kryesor në zbatimin e nenit 30 të LMF-së, nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përbën shkelje të nenit 65 të LMF-së.
115. Avokati i Popullit vlerëson se moszbatimi i autorizimeve ligjore që dalin nga Ligji nr. 02/L-121 për vendbanimin dhe vendqëndrimin, më saktësisht mosmbajtja e evidencës për mysafirët, kishte penguar zhvillimin e hetimeve për organet e hetuesisë dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale kundër integritetit seksual.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: *“Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve tjera shtetërore”*. Sipas kuptimit të nenit 18, paragrafi 1.2, të Ligjit për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit: *“[...] ka përgjegjësi të tërheq*



vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla [...]", si dhe: "të rekomandojë [...] nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga Institucionet e Republikës së Kosovës." (neni 18, paragrafi 1.7).

Prandaj, Avokati i Popullit i

## REKOMANDON

### Këshillit Prokurorial të Kosovës

- *Ndërmarrjen e masave për sigurimin e llogaridhënies për zyrtarët përgjegjës të përfshirë në rast, për shkak të dështimit që t'i përmbushnin detyrimet ligjore.*
- *Trajnimin e detyrueshëm të zyrtarëve që merren me trajtimin e rasteve ku fëmijët janë viktima/dëshmitarë, masat mbrojtëse në dispozicion dhe interesin më të mirë të fëmijës.*
- *Në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale apo dëshmitar, rastet e tilla të trajtohen në mënyrë efektive dhe me urgjencë, në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës.*
- *Në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë, të përgatisë module të veçanta trajnimi për prokurorë lidhur me të miturit, veçmas për Pjesën e Pestë (Mbrojtja e fëmijëve viktima të veprave penale) të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës dhe për Kreun e pestë të Ligji nr. 04/L-218 për Parandalimin dhe Luftimin e Trafikimit me Njerëz dhe Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimi.*
- *Ngritjen e kapaciteteve profesionale të mbrojtësve të viktimave lidhur me rastet kur fëmijët janë viktima të trafikimit, përmes trajnimit të detyrueshëm, veçmas për Pjesën e Pestë (Mbrojtja e fëmijëve viktima të veprave penale) të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.*
- *Në rastet kur fëmija është dëshmitar apo viktimë e krimit, të sigurohet përfaqësim ligjor falas sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.*

### Policisë së Kosovës

- *Në rastet kur fëmija është viktimë e dhunës seksuale apo dëshmitar, rastet e tilla të trajtohen në mënyrë efektive dhe me urgjencë, në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës.*
- *Në rastet kur fëmija është dëshmitar apo viktimë e krimit, të sigurohet përfaqësim ligjor falas sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.*
- *Për zyrtarët policorë që punojnë më fëmijë si dëshmitarë apo si viktima të krimit, të ofrohen trajnime profesionale, veçmas për Pjesën e Pestë (Mbrojtja e fëmijëve viktima të veprave penale) të Kodit të Drejtësisë për të Mitur dhe për Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.*



## **Ministrisë së Punëve të Brendshme**

- *Ta bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit nr. 02/l-121 për vendbanimin dhe vendqëndrimin, veçmas tek mbajtja e evidencës për mysafirë, siç kërkohet nga objektet turistike dhe hoteliere.*
- *Të hetojë dhe të ndërmarrë masat përkatëse ligjore ndaj personave përgjegjës për mosmbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 02/l-121 për vendbanimin dhe vendqëndrimin, veçmas tek mbajtja e evidencës për mysafirë, siç kërkohet nga objektet turistike dhe hoteliere.*

## **Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve**

- *Ta hartojë aktin nënligjor për organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës, si parakusht kryesor në zbatimin e nenit 30 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, dhe ta dërgojë për miratim në Qeverinë e Republikës së Kosovës sa më parë të jetë e mundur.*
- *T'i përcaktojë standardet dhe ta miratojë themelimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijëve, sipas nenit 30, paragrafi 2, të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.*
- *T'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për sigurimin e psikologëve në Strehimore.*

## **Agjencisë së Kosovës për Forenzikë**

- *T'i përcaktojë procedurat e detajuara dhe afatet prej momentit kur i pranon dëshmitë, respektivisht lëndët të cilat dërgohen për ekspertim e deri te dërgimi i raportit tek autoriteti kërkues, gjithherë kur janë të përfshirë fëmijët viktimë të dhunës seksuale.*
- *T'i zbatojë me urgjencë rastet e referuara nga organet kompetente, gjithherë kur janë të përfshirë fëmijët viktimë të dhunës seksuale.*

## **Instituti të Mjekësisë Ligjore**

- *Ta përfshijë në politikat dhe në dokumentet e brendshme të Institutit parimin e prioritizimit të rasteve që përfshijnë fëmijë viktimë të dhunës.*
- *T'i zbatojë me urgjencë rastet e referuara nga organet kompetente, gjithherë kur janë të përfshirë fëmijët viktimë të dhunës seksuale.*

## **Komunës së Prishtinës**

- *T'i rrisë kapacitetet profesionale të Organit të Kujdestarisë për ta ushtruar mandatin e plotë sipas ligjit, në rastet kur fëmijët janë viktimë të dhunës.*
- *T'i rrisë kapacitetet me numrin e nevojshëm të stafit profesional në Qendrën për Punë Sociale dhe të përgatisë module obliguese, të veçanta trajnimi për ta, veçmas sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe sipas Kodit të Drejtësisë për të Mitur, Pjesa e Pestë (Mbrojtja e fëmijëve viktimë të veprave penale).*

## **Qendrës për Punë Sociale në Prishtinë**

- *Qendra për Punë Sociale në të gjitha rastet kur fëmija vendoset apo qëndron në strehimore pa pëlqimin e prindërve apo kujdestarit, duhet të kujdeset që në pajtim me*



*nenin 27 të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, para se të skadojë afati prej shtatëdhjetë e dy (72) orëve, rastin ta paraqesë në gjykatën kompetente, e cila vendos për kujdestarinë e fëmijës.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj  
Avokat i Popullit

